

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË**

**Vlerësim i reagimeve komunale ndaj vendbanimeve
joformale në Kosovë**

Dhjetor, 2011

Mohim përgjegjësie:

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. HYRJE	4
2. KORNIZA INSTITUCIONALE DHE E POLITIKAVE	6
3. REAGIMET KOMUNALE NDAJ VENDBANIMEVE JOFORMALE	8
3.1 Identifikimi i vendbanimeve joformale	8
<i>Rajoni i Prizrenit</i>	8
<i>Rajoni i Pejës/Peç</i>	8
<i>Rajoni i Prishtinës/Priština</i>	9
<i>Rajoni i Gjilanit/Gnjilane</i>	10
<i>Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica</i>	12
<i>Përfundim</i>	13
3.2 Planifikimi hapësinor dhe praktikat e rregullimit	14
<i>Rajoni i Prizrenit</i>	15
<i>Rajoni i Pejës/Peç</i>	15
<i>Rajoni i Prishtinës/Priština</i>	17
<i>Rajoni i Gjilanit/Gnjilane</i>	17
<i>Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica</i>	18
<i>Përfundim</i>	19
3.3 Pjesëmarrja në procesin e planifikimit hapësinor dhe të rregullimit	20
<i>Rajoni i Prizrenit</i>	21
<i>Rajoni i Pejës/Peç</i>	21
<i>Rajoni i Prishtinës/Priština</i>	22
<i>Rajoni i Gjilanit/Gnjilane</i>	22
<i>Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica</i>	23
<i>Konkludim</i>	24
4. KONKLUDIM	24
5. REKOMANDIME	26
Shtojca I: Vendbanimet joformale të identifikuara nga komunat	27

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vendbanimet joformale në Kosovë janë gjerësisht të karakterizuara nga mungesa e qasjes në infrastrukturën themelore dhe në shërbimet sociale. Duke qenë kështu, banorët shpeshherë jetojnë në kushte shumë të rënda dhe kanë një pozitë të margjinalizuar brenda shoqërisë. Mungesa e zotërimit të sigurt është gjithashtu një karakteristikë e theksuar e vendbanimeve joformale, të cilat zakonisht nuk ndërtohen në pajtim me planet hapësinore, u mungojnë lejet e nevojshme të ndërtimit, si dhe nuk regjistrohen në regjistrat kadastral. Në veçanti është jashtëzakonisht e vështirë për ta fituar zotërimin e sigurt në rastet kur shtëpitë ndërtohen në tokë komunale apo në pronësi shoqërore, gjë që i lë banorët shumë të cenueshëm ndaj dëbimit me dhunë.

Ndonëse shumë zyrtarë komunalë kanë njohuri shumë të mira për vendbanimet joformale, ende ekziston një shkallë e keqkuptimit në lidhje me kuptimin dhe përkufizimin e konceptit. Një numër i komunave përdorin ose një përkufizim tepër të ngushtë, ose tepër të gjerë që mund të jetë një pengesë për identifikimin e mirëfillt të vendbanimeve joformale në fushën e tyre të përgjegjësisë. Si të tilla, ato vendbanime ku banorët janë shumë të cenueshëm mund të mos jenë prioritet për planet rregullative dhe projektet.

Disa komuna në Kosovë e kanë marrë përsipër hartimin e planit hapësinor. Ky është një prej mekanizmave parësor nëpërmjet të cilit komunat mund të identifikojnë dhe rregullojnë vendbanimet joformale në fushën e tyre të përgjegjësisë. Shumë komuna kanë përfshirë vendbanimet joformale të identifikuar në planet e tyre hapësinore, gjë që është një hap i rëndësishëm drejt zgjidhjes së zotërimit të sigurt dhe qasjes në infrastrukturën themelore dhe në shërbimet sociale. Korniza e politikave përcakton që rregullimi *in situ* duhet të jetë normë, kurse rregullimi nëpërmjet rivendosjes duhet të përdoret si mjet i fundit në rrethana të veçanta kur zotërimi i sigurt ose banimi i përshtatshëm nuk mund të sigurohen në vend. Në pajtim me këtë, komunat në përgjithësi zgjedhin rregullimin *in situ*. Megjithatë, ekzistojnë disa përjashtime ku rivendosja e banorëve është ndërmarrë për shkak se zotërimi i sigurt nuk mund të sigurohej, ose për shkak se vendbanimi është i vendosur në një hapësirë të rrezikshme mjedisore. Kjo strategji e rivendosjes ka funksionuar mirë në rastet kur banorët janë fuqizuar nëpërmjet konsultimit efektiv me komunën dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje.

Rëndësia e pjesëmarrjes dhe përfshirja e banorëve të vendbanimeve joformale në procesin e identifikimit, planifikimit hapësinor dhe rregullimit nuk duhet të nënvlerësohet. Aty ku ekzistojnë mekanizmat zyrtar për pjesëmarrje (si komisionet e themeluara me qëllim të përfshirjes së të gjithë hisedarëve në procesin e rregullimit), komunitetet e ndikuara në përgjithësi kanë qasje më pozitive ndaj komunave të tyre gjegjëse, janë më të informuar për nismat komunale që prekin shtëpitë e tyre dhe janë më të përfshira në proceset e vendimmarrjes. Në mënyrë të anasjellë, aty ku nuk ekzistojnë mekanizmat zyrtar dhe joformal, banorët janë shpesh të keqinformuar dhe ndiejnë se mendimet dhe shqetësimet e tyre nuk përfillen nga komuna.

Gjitha vendbanimet joformale në gjithë Kosovën duhen identifikuar dhe përfshirë brenda planeve hapësinore komunale, derisa rregullimi në terren duhet ndërmarrë kudo që është e mundur. Për më tepër, është me rëndësi jetike që institucionet lokale të zhvillojnë mekanizma për përfshirjen e banorëve në gjitha proceset e ndërlidhura me rregullimin e vendbanimeve joformale. Për më tepër, komunat duhet të kërkojnë mënyra për themelimin e mekanizmave për këmbimin e informatave dhe praktikave më të mira në lidhje me rregullimin. Për të

përkrahur këto procese, ka nevojë të dukshme për mbështetje të vazhdueshme teknike dhe financiare për institucionet e nivelit komunal nëpërmes proceseve të identifikimit, planifikimit hapësinor dhe rregullimit.

1. HYRJE

Çështja e vendbanimeve joformale është shumë e përhapur në Kosovë. Mungesa e të dhënave të besueshme të regjistrimit të popullsisë, së bashku me faktin që identifikimi i vendbanimeve joformale është një proces i vazhdueshëm, e bën të pamundshëm llogaritjen e numrit të personave të cilët jetojnë në vendbanimet joformale. Megjithatë, në kohën e hartimit të këtij raporti, zyrtarë nga 19 komuna kanë identifikuar në përgjithësi 95 vendbanime joformale në tërë Kosovën.¹ Këto vendbanime dallojnë shumë për nga forma dhe mund të përbëhen nga disa shtëpi, ose ato mund të formojnë lagje të tëra apo fshatra me qindra, madje edhe mijëra banorë në secilën prej tyre. Në disa raste, zyrtarët kosovarë kanë identifikuar qendrat e përkohshme kolektive për personat e zhvendosur në Kosovë si vendbanime joformale.

Një përkufizim i vendbanimeve joformale në Kosovë përcaktohet me Ligjin për planifikim hapësinor² ndërsa dokumentet e politikave që zbatohen në Kosovë³ përcaktojnë variante të lehta të këtij përkufizimi. Në përgjithësi, elementet kryesore mund të përmbliidhen si në vijim:

1. Zotërim i pasigurt i pronësisë;
2. Qasje joadekuate në shërbimet themelore, infrastrukturë dhe standarde humanitare;
3. Qasje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje.

Këto kritere përkufizuese janë ngushtë të lidhura me të drejtën e banimit të përshtatshëm që është “është e drejta për të jetuar kudo në siguri, paqe dhe dinjitet”.⁴ Kriteri i parë, zotërimi i

¹ Shih Shtojcën I për listën e plotë të vendbanimeve joformale siç janë identifikuar nga zyrtarët komunalë.

² Shih nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikimin hapësinor, siç është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-106 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, 10 nëntor 2008, që përkufizon vendbanimet joformale si “vendbanime njerëzore të cilat nuk u mundësojnë banorëve të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, në veçanti banim të përshtatshëm. Si të tilla, vendbanimet joformale mund të kenë karakteristikat si në vijim: a) zotërim joformal i pronësisë, b) qasje joadekuate ose privim në shërbime elementare, c) pjesëmarrje joadekuate ose mos pjesëmarrje në qeverisje dhe d) rrezikshmëri e lartë.”

³ Deklarata e Vjenës për vendbanimet joformale në Evropën Juglindore (Deklarata e Vjenës), e nënshkruar në Prishtinë/Priştina më 17 mars 2005, përcakton që vendbanimet joformale “kryesisht karakterizohen me zotërim joformal apo të pasigurt të tokës, qasje joadekuate në shërbime themelore, si në atë sociale ashtu dhe në atë infrastrukturore dhe financa të vendbanimit” (faqe 1). Udhëzimet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për planifikimin hapësinor të vendbanimeve joformale, 2005, theksojnë që “Vendbanimet joformale janë vendbanime njerëzore që nuk ua mundësojnë banorëve të tyre gëzimin e të drejtave për standard të duhur të jetesës, në veçanti për banim adekuat. Si të tilla, vendbanimet joformale mund të kenë karakteristikat vijuese: zotërim joformal apo të pasigurt të pronës; Infrastrukturë joadekuate; mjedis jo të shëndosh; dendësi të pakontrolluar të popullsisë; Vendosje apo akomodim të papërshtatshëm; qasje joadekuate në, apo privim nga shërbimet themelore; mospjesëmarrje ose pjesëmarrje joadekuate në qeverisje; rrezikshmëria deri në diskriminim” (pjesa e “përkufizimit”).

⁴ Shih paragrafin 7, Komentet e Përgjithshme 4: e drejta për banim të përshtatshëm, Komisioni i OKB-së për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, 13 dhjetor 1991. Në paragrafin 8, Komisioni i OKB-së më tej përcakton disa kritere që duhet të merren parasysh kur vendoset nëse një formë e veçantë e strehimit mund të konsiderohet si banim i përshtatshëm; zotërimi juridik i pronësisë; disponueshmëria e shërbimeve, materialeve, hapësirave dhe infrastrukturës; përballueshmëria financiare, gjendja e banimit, qasja; vendndodhja; përshtatshmëria kulturore. E drejta për banim të përshtatshëm përcaktohet me nenin 11 të Paktit ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (PNDESK). Ndonëse nuk zbatohet

sigurt, është gur themel i së drejtës për banim adekuat duke qenë se i mbron njerëzit nga dëbimi arbitrar apo i dhunshëm, keqtrajtimi dhe kërcënimet tjera.⁵ Vendbanimet joformale mund të ndërtohen në pronë private ose në pronë shoqërore. Në këtë të fundit, siguria e zotërimit mund të arrihet shumë vështirë duke qenë se komuna mund të mos jetë në gjendje që jep të drejtën e përdorimit të tokës. Megjithatë, disa vendbanime janë ndërtuar në pronën private të banorëve por nuk janë ndërtuar në pajtim me planet hapësinore dhe prandaj atyre u mungojnë lejet e domosdoshme. Kjo gjithashtu mund t'i lë banorët të cenueshëm ndaj dëbimit apo ndërhyrjeve tjera në pronën e tyre. Pa zotërim të sigurt, banorët janë të cenueshëm ndaj dëbimit të dhunshëm dhe kjo po ashtu mund të rrezikojë të drejtën e kthimit të personave të zhvendosur. Kjo përfshin edhe të drejtat e garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJLTh), gjegjësisht të drejtën e pronës dhe të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare.⁶

Kriteri i dytë është gjithashtu i lidhur me të drejtën për banim të përshtatshëm. Ai është i lidhur për faktin se vendbanimet joformale karakterizohen nga mungesa standardeve të përshtatshme apo të pranueshme të banimit, si mungesa e qasjes në infrastrukturën publike⁷ dhe në shërbimet sociale,⁸ cilësia e dobët e banimit dhe/ose mjedisi i dëmshëm për jetë.

Kriteri i tretë, gjegjësisht qasja joadekuate apo mospjesëmarrja në qeverisje, ka të bëjë me faktin që komunitetet në vendbanimet joformale janë shpeshherë të marginalizuara, dhe nuk përfaqësohen dhe nuk kanë qasje në organet vendimmarrëse. E drejta e personave për të marrë pjesë në çështjet që kanë ndikim tek ata, është gjithnjë e më shumë duke u konfirmuar me të drejtën ndërkombëtare.⁹

Rregullimi i vendbanimeve joformale do të thotë garantim i zotërimit të sigurt të pronësisë dhe standarde të përshtatshme banimi për të gjithë banorët e vendbanimeve joformale në të cilat këto dy kritere nuk janë plotësuar. Planifikimi hapësinor mund të ndihmojë shumë në rregullimin e vendbanimeve joformale, meqenëse planet hapësinore komunale përcaktojnë se ku do të jetë infrastruktura fizike dhe shërbimet sociale. Planifikimi hapësinor është gjithashtu i lidhur me zotërimin e sigurt duke qenë se është proces nëpërmjet së cilit krijohen zonat rezidenciale, prandaj përcakton se në cilin rast dikush mund të marr ose jo lejen e ndërtimit për shtëpitë private.

Gjithnjë e më shumë, zhvillimi i skemave të përballeshme sociale dhe të banimit po pranohet si mënyrë për të rregulluar çështjen e vendbanimeve joformale. Prandaj, ai duhet të parandalojë zhvillimin e vendbanimeve tjera joformale duke siguruar qasje të përballeshme në banim të përshtatshëm.

drejtpërdrejt në Kosovë, PNDESK është një instrument i rëndësishëm duke qenë se krijon një normë të pranuar në nivel ndërkombëtar.

⁵ Shih paragrafin 8, po aty.

⁶ E drejta e pronës përcaktohet me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJLTh), ndërsa e drejta e jetës private dhe familjare përcaktohet me nenin 8 të KEDNJLTh. Në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës, KEDNJLTH zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë.

⁷ Shërbimet publike përfshijnë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, rrugët e asfaltuara ose të shtruara, furnizimin me energji elektrike, transportin publik dhe mbledhjen e mbeturinave.

⁸ Të tilla si qasja në arsim, kujdes shëndetësor, shërbime të mirëqenies sociale dhe shërbime emergjente (zjarrfikësi, ndihma e shpejtë, policia).

⁹ Shih nenin 15 të Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Njësoj si me KEDNJLTh, edhe KKMPK zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë në bazë të nenit 22 të Kushtetutës. Kjo e drejtë është gjithashtu e përcaktuar me Konventën për qasjen në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasjen në drejtësi në fushën e mjedisit (Konventa Aarhus).

Në këtë raport shqyrtohet qasja e komunave ndaj zgjidhjes së çështjes së vendbanimeve joformale dhe gjithashtu identifikohen disa të mangësi dhe sfida kryesore me të cilat ballafaqohen komunat. Fillimisht, ai i përvijon kornizën institucionale dhe të politikave në Kosovë që lidhen me vendbanimet joformale. Më pas ai vlerëson kuptimin e zyrtarëve komunalë të konceptit të vendbanimeve joformale dhe se si i identifikojnë ata këto vendbanime në fushat e tyre gjegjëse të përgjegjësisë. Rrjedhimisht, raporti i shqyrton praktikën e planifikimit hapësinorë dhe të rregullimit në komuna dhe si rreshtohen ato me kornizën e politikave. Në fund, raporti paraqet një vlerësim të nivelit të pjesëmarrjes së banorëve të vendbanimeve joformale në procesin e vendimmarrjes në lidhje me identifikimin dhe rregullimin e këtyre vendbanimeve. Gjetjet e raportit bazohen në informatat e marra nga zyrtarët komunalë dhe banorët e vendbanimeve joformale gjatë intervistave të kryera në fund të vitit 2010 nga Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

2. KORNIZA INSTITUCIONALE DHE E POLITIKAVE

Korniza ligjore dhe e politikave në Kosovë ripohon detyrimet e vëna për institucionet lokale për identifikimin dhe rregullimin e të gjitha vendbanimeve joformale. Rregullimi duhet ndërmarrë me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetës së banorëve dhe parandalimit të krijimit të vendbanimeve tjera joformale.

Në Kosovë janë miratuar disa dokumente politikash dhe strategji në lidhje me vendbanimet joformale. Ato sigurojnë një kornizë institucionale për menaxhimin e procesit të rregullimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të banorëve të vendbanimeve joformale. Në vitin 2005, në Prishtinë/Priştina është nënshkruar Deklarata e Vjenës për vendbanimet joformale në Evropën Juglindore (Deklarata e Vjenës).¹⁰ Qëllimi i saj është rënia dakord për veprimet që do të rregullonin dhe legalizonin vendbanimet joformale në një mënyrë të qëndrueshme dhe që do të parandalonte krijimin e vendbanimeve tjera joformale. Për më tepër, dokumenti konfirmon të drejtën e të gjithë banorëve për një standard të përshtatshëm të jetës dhe për qasje të barabartë në shërbime. Me shërbim të këtij qëllimi, ai siguron që rregullimi *in situ* (në vend) dhe përmirësimi duhet të bëhet sa më shumë që është e mundur¹¹, d.m.th., nëse kriteret përkufizuese të zotërimit të sigurt dhe qasjes joadekuade në shërbimet themelore dhe në standardet humanitare mund të përmirësohen në vendin ku jetojnë banorët. Në disa raste, kjo nuk është e mundur dhe mund të ketë rivendosje; për shembull, nëse zotërimi i sigurt nuk mund të garantohet në vend apo nëse vendbanimi gjendet në një hapësirë të rrezikshme mjedisore. Deklarata e Vjenës gjithashtu përcakton se zgjidhjet rajonale për vendbanimet joformale duhet të përfundohen deri më 2015.

Plani kosovar për zbatimin e standardeve (PKZS) dhe plani i veprimit i Kosovës për zbatimin e partneritetit evropian (PVPE)¹² kanë përcaktuar detyrime të hollësishme për institucionet e

¹⁰ Kjo deklaratë u nënshkrua fillimisht nga Shqipëria, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia në vitin 2004.

¹¹ Shih faqen 2, "Përfaqësuesit kombëtar dhe rajonal nga Evropa Juglindore janë pajtuar për si në vijim ... për të ndërmarrë rregullimin *in situ* dhe përmirësimin deri në shkallë maksimale".

¹² PZSK u shpall nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe Kryeministri i Kosovës më 10 dhjetor 2003. Për atë kishin rënë dakord institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë dhe UNMIK-u dhe ai ishte miratuar nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara. PZSK është një plan i hollësishëm që përshkruan veprimet konkrete që duhet ndërmarr për plotësimin e një game standardesh në tetë fusha, duke përfshirë të drejtat pronësore, me qëllim që Kosova të bëhet një shoqëri funksionale dhe e

Kosovës, me qëllim të rregullimit të vendbanimeve joformale dhe gjetjes së zgjidhjeve të qëndrueshme për komunitetet të cilat jetojnë në kampe dhe për personat e zhvendosur të cilët jetojnë në qendrat e përkohshme.¹³

Pas nënshkrimit të Deklaratës së Vjenës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor (MMPH) ka hartuar udhëzimet¹⁴ për t'i ndihmuar komunat në përdorimin e planifikimit hapësinor si mjet për integrimin e vendbanimeve joformale. Udhëzimet konfirmojnë të drejtën e banorëve për qasje në infrastrukturën themelore dhe në shërbimet sociale, si dhe gëzimin e zotërimit të sigurt. Parimet kryesore të udhëzimeve janë: 1) qëllimi i planifikimit hapësinor duhet të jetë përmirësimi i kushteve brenda vendbanimeve joformale; 2) pjesëmarrja aktive e banorëve të vendbanimeve joformale në procesin e planifikimit dhe 3) një pjesëmarrje më e madhe e të gjitha komuniteteve dhe e shoqërisë civile në planifikimin hapësinor.

Ligji për planifikim hapësinor përcakton detyrimet e komunave dhe MMPH në lidhje me hartimin e planeve hapësinore. Disa prej parimeve në të cilat është bazuar ligji janë promovimi i pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve dhe transparenca në procesin e planifikimit.¹⁵ Sipas ligjit, komunat janë përgjegjëse për hartimin e planeve hapësinore që duhet të identifikojnë të gjitha vendbanimet joformale. Për më tepër, komunat duhet të vendosin se si ato duhet të rregullohen duke adresuar problemin e qasjes në infrastrukturë dhe shërbime sociale, si dhe duke adresuar çështjet në lidhje me zotërimin e pronësisë. Edhe pse Ligji për planifikim hapësinor fillimisht nuk kishte përcaktuar një përkufizim të vendbanimeve joformale, ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për planifikim hapësinor ka përcaktuar një përkufizim të tillë.¹⁶

Në pajtim me këtë kornizë ligjore dhe të politikave, rregullimi i vendbanimeve joformale duhet të bëhet në një mënyrë transparente dhe pjesëmarrëse për të siguruar qasjen në banim të përshtatshëm dhe zotërimin e sigurt për të gjitha komunitetet në Kosovë. Përveç kësaj, komunat kanë për detyrë përfshirjen e banorëve të vendbanimeve joformale në procesin e planifikimit dhe identifikimin e këtyre vendbanimeve në planet hapësinore me qëllim të rregullimit të tyre eventual.

PVPE po ashtu obligon qeverinë për të hartuar dhe zbatuar një strategji dhe një plan të veprimit për rregullimin e vendbanimeve joformale dhe për parandalimin e krijimit të vendbanimeve tjera joformale. Në këtë aspekt, MMPH ka hartuar një strategji dhe një plan të veprimit për parandalimin dhe rregullimin e vendbanimeve joformale në Kosovë (projekt-strategjia e MMPH) që pritet të miratohet në vitin 2011. Kjo strategji duhet të ndihmojë dhe inkurajojë edhe më shumë komunat për të rregulluar dhe integruar vendbanimet joformale në një mënyrë të qëndrueshme dhe për të parandaluar vendbanimet e ardhshme joformale. Sërish, projekt-strategjia e MMPH thekson nevojën për një qasje pjesëmarrëse.

qëndrueshme. Në vitin 2005, Komisioni Evropian, UNMIK-u dhe Zyra e Kryeministrit u pajtuan që PZSK të përfshihet në procesin afatgjatë të integritit evropian, duke hartuar kështu PVPE. Më 9 gusht 2006, Qeveria e Kosovës miratoi PVPE dhe ai përcakton masat që institucionet e Kosovës synojnë të ndërmarrin për arritjen e prioriteteve të përcaktuara me partneritetin evropian. Ai konfirmon detyrimet që burojnë nga PZSK, duke përfshirë nevojën e legalizimit dhe rregullimit të vendbanimeve joformale.

¹³ Veprimi 31 i planit të veprimit për zbatimin e partneritetit evropian, 2006.

¹⁴ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, udhëzimet për planifikimin hapësinor të vendbanimeve joformale, 2005.

¹⁵ Shih nenin 3.

¹⁶ Shih nenin 2.

Në veçanti, të dyja PVPE dhe projekt-strategjia e MMPH njohin rëndësinë e qasjes në banim social për luftimin dhe parandalimin e çështjes së vendbanimeve joformale nëpërmes sigurimit të qasjes në strehim të përshtatshëm për ata persona të cilët përndryshe nuk kanë një mundësi të tillë financiare. Në pajtim me rekomandimet e PVPE, një ligji i ri për banim social u miratua më 2010.¹⁷

3. REAGIMET KOMUNALE NDAJ VENDBANIMEVE JOFORMALE

3.1 Identifikimi i vendbanimeve joformale

Në mbështetje të Deklaratës së Vjenës dhe udhëzimeve të MMPH, komunat duhet të identifikojnë cilëndo dhe të gjitha vendbanimet joformale që ekzistojnë në territorin e tyre me qëllimin përfundimtar të legalizimit dhe rregullimit të vendbanimeve dhe të përmirësimit të kushteve të jetës për banorët.

Rajoni i Prizrenit

Gjatë intervistave me zyrtarët komunalë në rajonin e Prizrenit, vetëm zyrtarët nga komuna e Prizrenit identifikuan me siguri ekzistencën e tre vendbanimeve joformale.¹⁸ Zyrtarët e intervistuar deklaruan që mungesa e zotërimit të sigurt është veçoria më e theksuar e vendbanimeve joformale të identifikuara. Vendbanimet “Farmakos” dhe “Ramiz Sadiku” janë të dyja ndërtesa publike (e para ishte konvikt studentor kurse dyta ishte barakë e punëtorëve në pronësi shoqërore) që aktualisht janë të uzurpuara nga familjet rurale të cilat kanë kërkuar strehim të përkohshëm menjëherë pas vitit 1999. Sipas komunës, uzurpuesit nuk gëzojnë asnjë të drejtë të përdorimit të ndërtesave. Banorët janë kryesisht shqiptarë të Kosovës dhe shumë prej tyre ende kanë prona në fshatrat e tyre gjegjëse. Disponueshmëria e infrastrukturës (uji i pijshëm, kanalizimi, energjia elektrike, rrugët) dhe e shërbimeve sociale (shëndetësia, arsimi dhe transporti publik) konsiderohet se është e mirë. Megjithatë, komuna theksoi që kushtet e banimit janë të këqija dhe që në përgjithësi gjendja ekonomike e banorëve mbështetet në një kombinim të punësimit të përkohshëm dhe ndihmës sociale.

Në vendbanimin e tretë në Prizren “Jeta e Re” jetojnë pjesëtarët e komunitetit rom. Në përgjithësi, qasja në infrastrukturë dhe shërbime sociale është e mirë dhe e krahasueshme me zonat tjera urbane në Prizren. Shumica e shtëpive janë ndërtuar nga pronarët në pronat e tyre private, përveç disave të cilat janë pjesërisht të ndërtuara në pronë komunale. E vetmja çështje kryesore e pazgjidhur është se shtëpitë janë ndërtuar pa leje ndërtimi, gjë që është e ngjashme me shumë zona tjera urbane dhe periferike në Prizren.

Zyrtarët komunalë në komunën e Malishevës/Mališevo nuk ishin të sigurt nëse fshati Stapanicë/Stepanica mund të cilësohet si një vendbanim joformal. Me sa duket, zyrtarët nuk ishin të sigurt për shkak se ata nuk kuptojnë se çfarë janë vendbanimet joformale dhe se si mund të identifikohen ato. Edhe këtu, shtëpitë ishin ndërtuar në pronën private të pronarëve.

Rajoni i Pejës/Peć

Në rajonin e Pejës/Peć, dy nga gjashtë komuna kanë identifikuar vendbanimet joformale: katër në komunën e Pejës/Peć¹⁹ dhe tre në Gjakovë/Đakovica²⁰. Sipas zyrtarëve në komunën

¹⁷ Ligji nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, 25 shkurt 2010.

¹⁸ Lagjet “Farmakos”, “Ramiz Sadiku” dhe “Jeta e Re”.

¹⁹ Lagjet “7 Shtatori”, “Kristali”, “Zatra” dhe “Asllan Çeshme”.

²⁰ Lagjet “Kolonia”, “Brekoc” dhe “Piskota”.

e Pejës/Peć, vendbanimet joformale në përgjithësi karakterizohen nga mungesa e zotërimit të sigurt. Lagjet “7 Shtatori”, “Kristali” dhe “Asllan Çeshme” kanë një përbërje të përzier etnike me shqiptarë, romë, ashkali ose egjiptianë të Kosovës, ndërsa në lagjen “Zatra” jetojnë shqiptarët e Kosovës. Në secilin vendbanim, disa ndërtesa janë ndërtuar në tokë komunale ndërsa disa të tjera janë ndërtuar në pronën private të vetë banorëve, ndonëse shumë pak prej tyre kanë tituj pronësor të regjistruar. Zyrtarët kanë theksuar që lagjet “Kristali” dhe “Zatra” janë në gjendje më të mirë sa i përket zotërimit të sigurt duke qenë se shumë prona janë ndërtuar në tokë në pronësi private, ndërsa vetëm disa janë ndërtuar në tokë në pronësi komunale. Këtu vendbanimet joformale nuk kanë qasje të duhur në shërbimet publike dhe infrastrukturë, si ujë, energji elektrike dhe mbledhje të mbeturinave. Në lagjet “7 Shtatori” dhe “Kristali”, gjendja ekonomike kryesisht mbështetet në një kombinim të punësimit dhe ndihmës sociale kurse kushtet e banimit janë mjaft të këqija. Siç raportohet, gjendja ekonomike dhe kushtet e banimit në lagjet “Zatra” dhe “Asllan Çeshme” janë shumë të mira sa i përket gjendjes ekonomike dhe kushteve të banimit.

Në komunën e Gjakovës/Đakovica, në vendbanimet joformale që janë identifikuar nga zyrtarët komunalë jetojnë romët, ashkalinjtë ose egjiptianët e Kosovës dhe disa shqiptarë të Kosovës. Zyrtarët kanë theksuar se ekziston një problem i veçantë në lidhje me zotërimin e sigurt, sipas të cilit vlerësohet se vetëm rreth 20 për qind e banorëve kanë pronë private ndërsa pjesa tjetër jetojnë ose në parcelat që ju takojnë ndërmarrjeve në pronësi shoqërore, ose në tokë komunale pa të drejtë shfrytëzimi.²¹ Për më tepër, vendbanimet “Kolonja” dhe “Brekoc” kanë probleme të theksuara në lidhje me qasjen në shërbimet themelore, si ujë, energji elektrike dhe kanalizim. Rasti i vendbanimit “Kolonja” është edhe më shqetësues, duke qenë se gjendet afër deponisë komunale dhe kështu banorët i nënshtrohen ndotjes së tepërt të ajrit dhe mbeturinave të rrezikshme. Qasja në shërbimet themelore sociale mendohet se është e keqe në secilin vendbanim. Kushtet e banimit gjithashtu mendohet se janë të papërshtatshme, me përjashtim të vendbanimit “Piskote” ku, siç raportohet, kushtet ekonomike janë më të mira.

Rajoni i Prishtinës/Priština

Në rajonin e Prishtinës/Priština, gjashtë prej tetë komunave kanë bërë identifikimin e vendbanimeve joformale: tri në komunën e Prishtinës/Priština²²; dy në komunën e Podujevës/Podujevo²³; tetë në komunën e Obiliqit/Obilić²⁴; shtatë në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje²⁵; tri në komunën e Glllogocit/Glogovac²⁶; dhe 15 në komunën e Gračanica/Gračanicës²⁷. Vendbanimet në komunën e Glllogocit/Glogovac ekzistojnë që nga viti 1999, ndërsa të tjerat kanë ekzistuar me dekada. Zyrtarët kanë identifikuar që pjesa

²¹ Sipas zyrtarëve komunalë, vendbanimi “Kolonja” është kryesisht tokë në pronësi shoqërore, ndërsa vendbanimet “Brekoc” dhe “Piskote” kanë përzierje të tokës në pronësi komunale dhe të asaj në pronësi private.

²² Lagjet “Ramiz Sadiku”, “Dodona”, (“Moravska” e mëparshme), dhe Kodra e Trimave/Vranjevac.

²³ Një lagje “Ashkali” në qytetin e Podujevës/Podujevo dhe “fshati i Kuwaiti” (vendbanim afër rrugës Podujevë/Podujevo - Merdar/Merdare).

²⁴ Lagjet “Subotiq”, “Azotika” dhe “Obiliqi i Ri”, fshati Plemetina/Plemetinë, kampi “Plemetina/Plemetinë”, fshati Janina Voda, fshati Dardhishtë dhe vendbanimi në fshatin Babin Most/Babimoc.

²⁵ Fshati Bresje, fshati Henc/Ence, fshati Lismir/Dobri Dub, “Vendbanimi 02”, “Vendbanimi 07”, “Vendbanimi 028” dhe “Vendbanimi 029”.

²⁶ Lagjet “Poklek i Ri” dhe “Feronikeli” dhe fshati Komoran/Komorane.

²⁷ Lagjet “Roma area”, “Padalište” dhe “Voçar” në qytetin e Gračanica/Gračanicës, dhe fshatrat e: Laplje Selo/Llapplassellë, Preoce/Preoc, Badovac/Badoc, Sušica/Sushicë, Lepina/Lepi, Skulanevo/Skullan, Radevo/Radevë, Dobrotin/Dobratin, Donja Gušterica/Gushtericë e Ulët, Gornja Gušterica/Gushtericë e Epërme, Livade/Livagjë, Suhodoll/Suvi Do, Batuse/Batushë dhe Ugljare/Uglar.

dërmuese e këtyre vendbanimeve janë të banuara nga shqiptarët dhe/ose romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës. Në Obiliq/Obilić, zyrtarët kanë vënë në dukje që shumë vendbanime kanë gjithashtu serbë të Kosovës që banojnë aty, ndërsa në Gračanica/Graçanicë, vendbanimet janë të banuara nga serbët dhe/ose romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës.

Për vendbanimet në komunën e Gllgocit/Glogovac dhe në lagjen “Obiliqi i Ri” si dhe në kampin e Plemetina/Plemetinës në komunën e Obiliqit/Obilić, zyrtarët kanë identifikuar si mungesë të zotërimit të sigurisë ashtu edhe mungesën e qasjes në shërbime publike themelore dhe infrastrukturë, si karakteristika kryesore të identifikuar të vendbanimeve joformale. Pjesa dërmuese e banorëve këtu jetojnë në tokën që është në pronësi të komunës dhe ekonomikisht varen nga mirëqenia sociale, kështu që ata nuk janë në gjendje të sigurojnë kushte më të mira të banimit. Sipas zyrtarëve komunal, vendbanimet joformale të identifikuar në komunën Podujevës/Podujevo dhe Fushë Kosovës/Kosovo Polje dhe në lagjet “Kodra e Trimave/Vranjevac” dhe “Ramiz Sadiku” në komunën e Prishtinës/Priština karakterizohen kryesisht me mungesë të zotërimit të sigurt. “Lagjja e ashkalive” në Podujevë/Podujevo dhe vendbanimet në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, janë të ndërtuara kryesisht në prona private të banorëve, ndërsa “fshati i Kuvajtit” në Podujevë/Podujevo gjendet në tokën e komunës. Për këtë të fundit, zyrtarët kanë deklaruar, që qytetarët kanë të drejtën e shfrytëzimit të pronave përmes kontratave me komunën. Megjithatë, për komunën e Prishtinës/Priština, zyrtarët kanë raportuar që vendbanimet janë ndërtuar pjesërisht në pronën private të banorëve dhe pjesërisht në tokat në pronësi të komunës ose në pronësi shoqërore. Disa banorë kanë fituar të drejtën e shfrytëzimit të disa ngastrave të tokës përmes kontratave individuale me ndërmarrjen përkatëse në pronësi shoqërore (në rastin e lagjes “Ramiz Sadiku”) ose me komunën.

Në rastin e komunës së Gračanica/Graçanicës, zyrtarët komunal kanë vënë në dukje se mungesa e infrastrukturës dhe qasja në shërbime themelore janë karakteristikat kryesore, që i identifikojnë vendbanimet joformale. Është interesant të vihet në dukje, që në rastin e Gračanica/Graçanicës, komuna ka shkuar më tej, duke theksuar që shumë vendbanimeve joformale të saj i mungon infrastruktura sociale siç janë: çerdhet, qendrat rinore dhe shtëpitë e pleqve, që paraqet një koncept më të gjerë të vendbanimeve joformale se sa shumicës së komunave. Pjesa dërmuese e banesave në Gračanica/Graçanicë janë ndërtuar në prona private dhe regjistruar në emrin e vetë banorëve. Gračanica/Graçanica e përdor një koncept relativisht të gjerë të vendbanimeve joformale, që i ka qar ata t’i konsiderojnë pothuajse të gjitha fshatrat në Gračanica/Graçanicë si vendbanime joformale. Pjesës dërmuese të vendbanimeve në komunën e Obiliqit/Obilić²⁸ gjithashtu i mungon qasja në infrastrukturë dhe shërbime themelore, ndonëse vendbanimet janë të ndërtuara kryesisht në tokën e komunës, me disa pjesë në pronat në pronësi të banorëve.

Rajoni i Gjilanit/Gnjilane

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, 6 prej 11 komunave e kanë bërë identifikimin e vendbanimeve joformale: 11 në komunën e Gjilanit/Gnjilane²⁹; gjashtë në Viti/Vitina³⁰; gjashtë në

²⁸ Lagjet “Azotika” dhe “Subotiq”, fshati Plemetina/Plemetinë, fshati Janina Voda, fshati Dardhishta dhe vendbanimi në fshatin Babin Most/Babimoc.

²⁹ Lagjja “Arbëria/Qenar qeshme”; lagjja “Dheu i Bardh/Belo Zemlje”; lagjja “Ivo Lola Ribar”; zona e “Zabeli” (fabrika bujqësore); lagja “Abdullah Presheva”; lagjja pa emër afër qendrës sportive, vendbaim pa emër përgjatë rrugës për Malishevës/Mališevo; zonë pa emër përgjatë rrugës Gllama; rrugë pa emër përgjatë rrugës unazore; rrugë pa emër ndërmjet fshatrave Pasjak dhe Livoc i Epërm/Gornji Livoc dhe zonë e paemër përgjatë rrugës për Prishtinë/Priština.

Ferizaj/Uroševac³¹; pesë në Kaçanik/Kaçanik³²; katër në Kamenicë/Kamenica³³; dhe vetëm një në Han të Elezit/Đeneral Janković³⁴. Në tërë rajonin e Gjilanit/Gnjilane, pjesa dërmuese e vendbanimeve të identifikuar janë të banuara nga shqiptarë, me vetëm disa romë, ashkali, egjiptian³⁵ dhe serbë të Kosovës³⁶. Mungesa e zotërimit të sigurt është karakteristikë e identifikuar në të gjitha komunat. Disa vendbanime joformale janë ndërtuar në pronat private të banorëve, ndërsa të tjerat në tokat e komunës ose në ato në pronësi shoqërore. Vendbanimet tjera gjenden pjesërisht në pronat private të banorëve dhe pjesërisht në tokën e komunës ose në atë në pronësi shoqërore. Zyrtarët kanë vërejtur në përgjithësi në tërë rajonin, që shumica e banorëve të vendbanimeve nuk e kuptojnë rëndësinë e procedurave administrative për ndërtim dhe as që posedojnë mjete të nevojshme financiare për përcjelljen e këtyre procedurave. Pjesa dërmuese e banorëve në tërë rajonin varen ekonomikisht nga mirëqenie sociale.

Për të gjitha komunat në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, mungesa e qasjes në infrastrukturën themelore dhe shërbimet publike siç janë uji, rryma, kanalizimi dhe rrugë të asfaltuara janë identifikuar nga zyrtarët komunal si brengë. Qasja në infrastrukturën shoqërore, siç janë edukimi, shërbimi i emergjencës dhe kujdesi shëndetësorë, është gjithashtu karakteristikë e identifikuar nga shumë komuna.³⁷ Kushtet e banimit të vendbanimeve në komunat e Kaçanikut/Kaçanik dhe Kamenicës/Kamenica janë vlerësuar kryesisht si të dobëta, ndërsa për komunat tjera kushtet në përgjithësi janë të përshtatshme.

Komuna e Gjilanit/Gnjilane, Vitisë/Vitina dhe Kamenicës/Kamenica më tutje kanë identifikuar vendbanimet joformale si zona ku nuk njihen si pjesë përbërëse ose pjesë e barabartë e njësisë komunale nga ana e autoriteteve komunale. Komuna e Gjilanit/Gnjilane dhe Vitisë/Vitina kanë deklaruar gjithashtu që ato janë zona ku ka rrezik për diskriminim, me gjasë për shkak të pranisë së komuniteteve joshumicë në vendbanimet joformale.

Sipas zyrtarëve komunalë, shumica e vendbanimeve joformale të identifikuar në komunën e Gjilanit/Gnjilane, Vitisë/Vitina, Kaçanikut/Kaçanik dhe Kamenicës/Kamenica, janë themeluar pas konfliktit të viteve 1998–1999.³⁸ Shumica e tyre banohen nga njerëzit, të cilët

³⁰ Lagjet “Vitia 1”, “Vitia 2” dhe “Vitia 3”, fshati Radivojc/Radivojce, fshati Drobesh/Drobeš dhe fshati Binçë/Binač.

³¹ Lagjet “Koçi Xoxe”, “Sallahane/Salahane”, “Halit Ibishi”, “Fabrika e tubave” (fabrika e tubave) dhe “Rrr. I. Rugova” dhe fshati Dubravë/Dubrava.

³² Pjesë e rrugës “Agim Bajrami”, Lagjja “Dushkaja 1 dhe 2”, Lagjja “Ramadan Agushi”, fshati Kashan/Kaşan dhe fshati Straža/Strazhë.

³³ Mahalla e romëve (qyteti i Kamenicës/Kamenica), Mahalla e romëve (fshati Berivojcë/Berivojce), Mahalla e romëve (fshati Hogoshtë/Ogošte) dhe vendbanimi në fshatin Bosce/Boscë.

³⁴ Në zonën e Brava-s, në veri-perëndim të Hanit të Elezit/Đeneral Janković.

³⁵ Lagjet “Abdullah Presheva” dhe “Ivo Lola Ribar” (komuna e Gjilanit/Gnjilane); fshati Radivojc/Radivojce (komuna e Vitisë/Vitina); Lagjet “Sallahane/Salahane” dhe “Halit Ibishi” dhe fshati Dubravë/Dubrava (komuna e Ferizajit/Uroševac); dhe Mëhalla e romëve në qytetin e Kamenicës/Kamenica, Mahalla e romëve në fshatin Berivojcë/Berivojce, Mëhalla e romëve në fshatin Hogoshtë/Ogošte (komuna e Kamenicës/Kamenica).

³⁶ Fshati Binçë/Binač (komuna e Vitisë/Vitina) dhe vendbanimi në fshatin Bosce/Boscë (komuna e Kamenicës/Kamenica).

³⁷ Komuna e Kamenicës/Kamenica, Hanit të Elezit/Đeneral Janković dhe Kaçanikut/Kaçanik.

³⁸ Lagje pa emër afër qendrës sportive, vendbanime pa emër përgjatë rrugës së Malishevës/Mališevo, zona e “Zabeli”, vendbanim pa emër përgjatë rrugës së Gllamës, lagjja “Dheu i Bardh/Belo Zemlje”, vendbanim pa emër përgjatë rrugës anazore, vendbanim i paemëruar ndërmjet fshatrave Pasjak dhe Livoc i Epërm/Gornji Livoc (komuna e Gjilanit/Gnjilane – të gjitha të banuara me shqiptarë të Kosovës). Fshatrat Binçë/Binač dhe Radivojc/Radivojce (komuna e Vitisë/Vitina). Pjesë e rrugës “Agim Bajrami”, lagjet “Dushkaja 1 dhe 2”

kanë lëvizur nga zona tjera apo të cilët janë zhvendosur nga shtëpitë ku më parë kanë gëzuar zotërim më të sigurt dhe tani nuk mund të ia dalin që të kenë qasje në banim formal në vendet ku gjinden aktualisht.

*Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica*³⁹

Në kohën e intervistës, katër prej gjashtë komunave në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica kanë bërë identifikimin e vendbanimeve joformale: tri në komunën e Mitrovicës/Mitrovica⁴⁰; gjashtë në Skenderaj/Srbica⁴¹; dhe tri në Vushtrri/Vučitrn⁴². Veç kësaj, një vendbanim joformal është identifikuar në Leposavić/Leposaviq⁴³ ndërsa në Mitrovica/Mitrovicën veriore janë identifikuar dy vendbanime joformale⁴⁴. Vendbanimet e identifikuara nga zyrtarët në Leposavić/Leposaviq dhe Mitrovica/Mitrovicën veriore janë kampet e përkohshme për personat e zhvendosur si rezultat i konfliktit të viteve 1998–1999.

Në komunën e Mitrovicës/Mitrovica, “Mëhalla e Romëve/Roma Mahala”, e banuar me romë dhe ashkali të Kosovës është rindërtuar pjesërisht me mbështetjen financiare të një numri të organizatave ndërkombëtare⁴⁵ dhe ka pasur shumë nisma për riintegrimin e banorëve të mëparshëm⁴⁶. Sipas zyrtarëve, lagjja “Brdjani/Kroi i Vitakut” banohet nga serbët, boshnjakët dhe shqiptarët e Kosovës dhe gjithashtu janë bërë punë të konsiderueshme për rindërtim dhe janë bërë përpjekje për legalizimin e objekteve.

Sipas zyrtarëve komunal, të gjitha vendbanimet joformale në komunën e Skenderajt/Srbica banohen nga shqiptarët e Kosovës, dhe të gjithë konsiderohen të kenë infrastrukturë adekuate dhe qasje në shërbime. Për më tepër, shumica e shtëpive janë ndërtuar në prona private dhe i janë nënshtruar procesit legjislativ. Siç raportohet, në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn, vendbanimet që banohen nga shqiptarët e Kosovës janë gjithashtu shumë të këqija. Ekziston qasje e kufizuar në ujë të pijshëm dhe kanalizim dhe kushtet e banimit konsiderohen të jenë të dobëta. Për më tepër, pronat janë ndërtuar ose në tokat komunale ose në tokat në pronësi

dhe “Ramadan Agushi” dhe fshati Strazhë (komuna e Kačanikut/Kaçanik). Sipas komunës, të gjitha vendbanimet në komunën e Kamenicës/Kamenica kanë ekzistuar që nga viti 2000.

³⁹ As Mitrovica/Mitrovica, që është nën Administratën e UNMIK-ut në Mitrovicë, as strukturat e drejtuara nga serbët në komunat veriore (Leposavić/Leposaviq, Zvečan/Zvečan dhe Zubin Potok) nuk i njohin ose zbatojnë ligjet e Kuvendit të Kosovës ose aktet nënligjore të nxjerra nga ministritë e qeverisë së Kosovës. Si rrjedhim, ata nuk i njohin dokumentet siç janë udhëzimet e MMPH-së ose Ligjin nr. 03/L-106 që e bënë ndryshim-plotësimin e Ligjit për planifikim hapësinor nr. 2003/14. Megjithatë, zyrtarët komunal kanë dhënë definicione gjithëpërfshirëse të vendbanimeve joformale dhe zyrtarët e Zvečan/Zveçanit gjithashtu i janë referuar Deklaratës së Vjenës.

⁴⁰ Lagjet Mëhalla e Romëve/Roma Mahala, Dy Korriku/Sitničko Naselje dhe Brdjani/Kroi i Vitakut.

⁴¹ Fshatrat Klinë e Epërme/Gornja Klina, Turiqec/Turicevac, Runik/Rudnik, Çirez/Ćirez, Prekaz i Epërm/Gornje Prekaze dhe Kopiliq i Epërm/Gornji Obilić.

⁴² Vendbanimet “Ambullanta e Vjetër”, “Baraka” dhe Ko-operativa/Preduzeća.

⁴³ Kampi për personat e zhvendosur.

⁴⁴ Kampet e personave të zhvendosur “Česmin Lug” dhe “Osterode”. Në kohën kur po raportohet, “Česmin Lug” është mbyllur dhe pjesa dërmuese e banorëve janë kthyer në Mëhallën e Romëve/Roma Mahala ose janë rivendosur përkohësisht në kampin “Osterode”.

⁴⁵ Përfshirë këtu Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë (ZNKE), Agjencinë për Zhvillim Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara (USAID), Agjencinë Evropiane për Rindërtim (AER) dhe qeverinë suedeze dhe norvegjeze. Partnerët implementues kanë përfshirë edhe Këshillin Danez për Refugjatë, Norwegian Church Aid dhe Mercy Corps.

⁴⁶ Aktivitetet për riintegrim kanë qenë pjesë përbërëse e të gjitha projekteve për kthim në Mëhallën e Romëve/Roma Mahala. Si pjesë e procesit të riintegritimit dhe në mënyrë që të ofrohet zotërim i sigurt komuna ka ndarë tokë për shfrytëzim afat gjatë dhe ekzistojnë gjithashtu marrëveshje trepalëshe të nënshkuara nga përfutuesit, komuna dhe donatorët, që parashihet e drejta për shfrytëzim 99 vjeçar të shtëpive të rindërtuara.

shoqëror dhe u mungon zotërimi i sigurt. Gjendja është e ngjashme për lagjen “Dy Korriku/Sitničko Naselje” në komunën e Mitrovicës/Mitrovica, që banohet nga shqiptarët dhe ashkallitë e Kosovës. Dallimi këtu është që pjesa dërmuese e ndërtimeve janë në pronë private, por banorët nuk kanë mundur ta regjistrojnë titullin e tyre.

Kampi i personave të zhvendosur në komunën e Leposavić/Leposaviqit është themeluar për komunitetin romë dhe ashkali të zhvendosur nga “Mëhalla e Romëve/Roma Mahala” në Mitrovicën/Mitrovica jugore, në qershor të vitit 1999. Sipas zyrtarëve, kampi gjendet në tokën komunale dhe është shënjuar me qasje joadekuade në infrastrukturë themelore siç janë uji dhe kanalizimi. Për më tepër, barakat në vendbanim nuk janë adekuate për banim dhe nuk i plotësojnë kriteret për banim adekuat.

Përfundim

Në tërë Kosovën, zyrtarët komunal në 19 komuna kanë identifikuar gjithsej 95 vendbanime joformale. Shumë prej zyrtarëve komunal të intervistuar janë shprehur se e kanë kuptuar mirë konceptin e vendbanimeve joformale dhe i janë referuar më së shumti kriterëve të përcaktuara. Në përputhje me këtë, vendbanimet joformale të identifikuar nga zyrtarët komunal, në përgjithësi i plotësojnë këto kriterë, veçanërisht në lidhje me mungesën e zotërimit të sigurt, shërbimet publike themelore dhe infrastrukturën si dhe me mungesën e qasjes në infrastrukturën sociale. Në mënyrë tipike, ato nuk janë ndërtuar në përputhje me planet urbanistike dhe si rrjedhim nuk kanë leje për ndërtim. Ato mund të ndërtohen në tokën private të vetë banorëve ose mund të ndërtohen në tokën në pronësi publike ose shoqërore, ku banorëve u mungon regjistrimi i titujve pronësorë. Në rastin më të fundit, ekziston një rrezik i caktuar për dëbim, nëse atyre nuk u lejohet ndonjë e drejtë për shfrytëzim.⁴⁷

Megjithatë, disa komuna ende tregojnë shkallë të moskuptimit të kriterëve të përcaktuara. Pjesa dërmuese e tyre nuk i janë referuar kriterit të tretë të përcaktuar në mënyrë joadekuate ose për mospjesëmarrje në qeverisje. Për më tepër, disa komuna kanë një koncept shumë të ashpër për vendbanimet joformale dhe përqendrohen vetëm në kriteret e mungesës së zotërimit të sigurt. Ky ka qenë rasti me komunën e Vushtrrisë/Vučitrn dhe Prizrenit. Komuna e Prizrenit ka shkuar edhe më tutje në asociimin e vendbanimeve joformale me tokën komunale dhe objektet që kanë qenë të uzurpuara, që e parandalon komunën nga të gëzuarit e të mirave për ofrimin e asaj toke kompanive private për ndërtimin e objekteve banesore/afariste. Komunitat tjera (Dragashi/Dragaš, Istogu/Istok dhe Gjakova/Đakovica), derisa iu referonin disa kriterëve të përcaktuara, miratuan gjithashtu një koncept të ngushtë të vendbanimeve joformale, duke i lidhur ato me praninë e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian të Kosovës. Kjo mund të jetë çorientuese, meqë kriteret e përcaktuara nuk i referohen përkatësisë etnike. Komuna e Gračanica/Gračanicës, ka një koncept shumë të gjerë të vendbanimeve joformale dhe i radhit të gjitha fshatrat dhe një numër të zonave të vetë qytetit si vendbanime joformale.

Rreziku i kuptimit në mënyrë shumë strikte të kriterëve të përcaktuara është që disa zona mund të mbeten të paidentifikuara si vendbanime joformale dhe kështu mund të mbeten jashtë proceseve për rregullim dhe përmirësim dhe jashtë përfshirjes në projekte. Në anën tjetër, përdorimi i definicionit shumë të gjerë mund të qojë në përfshirjen e zonave komunale, të cilat gëzojnë kushte më të mira se të tjerat dhe duke mos i dhënë prioritet të duhur zonave

⁴⁷ E drejta zyrtare për shfrytëzimin e tokës mund t'i lejohet ligjërisht palëve, të cilët nuk kanë pronësi të vetë tokës. Shih Ligjin nr. 03/L-226 për Dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajshme të Komunës, 28 tetor 2010.

që kanë më së shumti nevojë. Si rrjedhim, komunat mund të mos i përmbushin obligimet e tyre në mënyrë adekuate sipas Deklaratës së Vjenës dhe udhëzuesit të MMPH-së.

Në disa instanca, qendrat e përkohshme kolektive për personat e zhvendosur si rezultat i konfliktit të viteve 1998–99, janë definuar gjithashtu nën ombrellën e vendbanimeve joformale.⁴⁸ Disa karakteristika të këtyre qendrave përzihen me këto të vendbanimeve joformale dhe personat e zhvendosur që jetojnë në këto qendra gëzojnë të drejtën e njëjtë për banim adekuat si banorë të vendbanimeve joformale. Megjithatë, qendrat e përkohshme kolektive janë themeluar si zgjidhje e përkohshme për zhvendosje. Duhet të theksohet që personat e zhvendosur, të cilët jetojnë në këto qendra kolektive të përkohshme kanë të drejta tjera që u njihen ndërkombëtarisht dhe qëllimi duhet të jetë gjithmonë që të ndihmohen këta persona për t'u kthyer në vendet e tyre të origjinës ose shtëpitë e tyre të mëparshme (ku dëshirohet dhe ku e realizueshme) ose të gjenden zgjidhje të përhershme alternative dhe të qëndrueshme jashtë këtyre qendrave të përkohshme.⁴⁹

3.2 Planifikimi hapësinor dhe praktikat e rregullimit

Në Kosovë, ekzistojnë tri lloje të ndryshme të planeve hapësinore në nivelin komunal⁵⁰:

- Plani zhvillimor komunal (PZHK): përcakton synimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor për komunë, për periudhën kohore më së paku pesë vjeçare.
- Plani zhvillimor urban (PZHU): përcakton projeksionet afatgjate për zhvillimin dhe menaxhimin e zonave urbane për periudhën më të paktë pesë vjeçare.
- Plani rregullues urban (PRU): definon zonat ndërtimore dhe përcakton në hollësi kushtet për rregullimin e hapësirës dhe rregullave për vendosjen e ndërtesave në ngastrat tokësore urbane. Duhet të shqyrtohet çdo pesë vjet.

PZHK mbulon tërë territorin e komunës, ndërsa PZHU mbulon vetëm zonën urbane (zakonisht vetëm qytetin ose qytezën kryesore të komunës). Me të gjitha këto, komuna duhet pastaj të zhvillojë një numër të PRU-ve, në mënyrë që të rregullojë zona të veçanta në kuadër të qytetit kryesor. Këto plane hapësinore janë mekanizmat kryesor komunal, që mund të përdoren për të iu adresuar çështjes së vendbanimeve joformale. Së pari, vendoset se çfarë lloji i ndërtesave mund të ndërtohen në zona të caktuara.⁵¹ Si të tilla, ato janë thelbësore për të iu adresuar kriterit të përcaktuar për zotërimin e sigurt. Së dyti, ato përcaktojnë se ku do të vendoset infrastruktura themelore dhe shërbimet shoqërore dhe parashohin se ku do të zë vend zhvillimi i këtyre shërbimeve në të ardhmen. Në këtë drejtim, këto janë të domosdoshme në adresimin dhe përmirësimin e qasjes në shërbime- kriteri i dytë i përcaktuar për vendbanimet joformale.

⁴⁸ Kampi i Plemetina/Plemetinës, komuna e Obiliqit/Obiliç; kampi i personave të zhvendosur në komunën e Leposaviç/Leposaviqit; kampet “Çesmin Lug” dhe “Osterode”, komuna e Mitrovicës/Mitrovica; lagjet “Voçar” dhe “Padalište”, qyteti i Gračanica/Graçanicës.

⁴⁹ Shih Parimet e Kombeve të Bashkuara mbi rikthimin e pronës banesore dhe pronës për refugjatë dhe personat e zhvendosur (2005) (‘Parimet e Pinheiros’), Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare dhe Parimet Udhëzuese për Zhvendosjen e Brendshme (1998), Kornizën e Kombeve të Bashkuara për Zgjidhje Afatgjate të Personave të Zhvendosur Brenda Vendit.(2009).

⁵⁰ Sipas Ligjit për planifikim hapësinor.

⁵¹ Sipas nenit 36 të Ligjit nr. 2004/15 për ndërtimin, siç është shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/37, 14 tetor 2004, kërkohet “leje urbane” në mënyrë që të ndërtohet në mënyrë ligjore në Kosovë. Ky dokument tregon që ndërtimi është në pajtim me PZHK, PZHU dhe PRU.

Udhëzimet e MMPH-së janë nxjerrë në vitin 2005, pas nënshkrimit të Deklaratës së Vjenës, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i suksesshëm i tyre. Qëllimi i udhëzimeve të MMPH-së është që ndihmojë komunat për shfrytëzimin e planifikimit hapësinor si mjet për integrimin e vendbanimeve joformale dhe përmirësimin e kushteve jetësore të banorëve. Në këtë drejtim, ato ofrojnë disa udhëzime se si të bëhen analizat paraprake të gjendjes dhe si të hartohen planet e veprimit për të iu adresuar vendbanimeve joformale në nivelin komunal përmes planifikimit hapësinor.

Njëri prej parimeve kryesore të udhëzimeve të MMPH-së dhe Deklaratës së Vjenës është që duhet të bëhen përmirësime në kuadër të vendbanimeve joformale ekzistuese. Kjo do të thotë që, rregullimi *'in situ'* duhet të jetë normë, ndërsa rivendosja duhet të jetë mundësia e fundit, përveç në rastet e jashtëzakonshme- siç janë rastet kur nuk mund të përmbushen standardet adekuate të banimit ose kur nuk mund të arrihet zotërimi i sigurt në atë vend- ku autoriteteve do të i duhet të ndjekin strategjinë për rivendosje. Në disa situata, mund të jetë shumë e vështirë për komunat që t'i adresohen zotërimit të sigurt, për shembull, nëse ata nuk kanë autorizim të kalojnë pronësinë e tokës ose të lejojnë të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pronësi shoqërore. Madje edhe në rastin e tokës në pronësi komunale, mund të lejojnë vetëm të drejtën e shfrytëzimit për një periudhë të caktuar kohore.⁵²

Rajoni i Prizrenit

Të gjitha komunat në rajonin e Prizrenit kanë deklaruar që janë në dijeni për udhëzimet e MMPH-së, përveç komunës së Prizrenit, e cila është e vetmja komunë që ka bërë identifikimin e vendbanimeve joformale në mënyrë të saktë. Në kohën kur është bërë intervista, PZHK-ja e komunës së Prizrenit ishte në fazën përfundimtare të hartimit, ndonëse tanimë e kishte përgatitur PZHU-në. Për më tepër, Prizreni ka miratuar shumë PRU, që nga viti 1999. Prizreni ka pranuar ndihmë nga disa organizata ndërkombëtare përmes procesit të hartimit e planit hapësinor⁵³ dhe komuna nuk i ka përdorur udhëzimet e MMPH-së gjatë procesit të planifikimit hapësinor, meqë pohojnë që nuk i kanë marrë ato. Megjithatë, ata thanë që kanë përdorur parime të ngjashme siç përfshihen në udhëzime, meqë janë këshilluar nga UN Habitat-i përmes procesit të hartimit dhe kanë marrë pjesë në punëtori të organizuara nga MMPH-ja për këtë çështje, në vitin 2010. Komuna e Prizrenit, në anën tjetër, ka zhvilluar plan të veçantë të rregullimit për identifikimin e vendbanimeve joformale. Brenga kryesore e komunës, sa i përket rregullimit është nëse banorët kanë titull pronësor për objektet në të cilat gjenden (duke nënkuptuar, nëse e ata janë në mënyrë joligjore në pronën publike/komunale). Sipas zyrtarëve, vendbanimet e identifikuar janë hapësira publike që janë zënë nga familjet rurale pas konfliktit 1998–99 dhe, me sa duket, shumica e tyre ende kanë prona në fshatrat e tyre të origjinës. Ata kanë qasje në infrastrukturë themelore por banesat ku jetojnë janë në gjendje të keqe. Në këtë rast, rregullimi përmes rivendosjes është opsioni i parapëlqyer i Prizrenit në mënyrë që të sigurojë tokë për ndërtimin e blloqeve banesore nga kompanitë private. Sipas zyrtarit të intervistuar, atyre që e kanë uzurpuar ilegalisht pronën komunale, do t'u ofrohet akomodim në ndërtesat e reja.

Rajoni i Pejës/Peć

Të gjitha komunat e rajonit të Pejës/Peć kanë konfirmuar të kenë përdorur udhëzimet e MMPH-së gjatë përgatitjes së planeve të tyre hapësinore. Mirëpo, siç u përmend më lart, vetëm komunat e Pejës/Peć dhe Gjakovës/Đakovica i kanë identifikuar vendbanimet

⁵² Neni 5 i Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës përcakton afatin 10 vjeçar për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 40 vjet me aprovimin e autoriteteve qendror.

⁵³ UN Habitat-i, Zyra Ndërkombëtare Civile dhe Trashëgimia Kulturore pa Kufij.

joformale. PZhK-të dhe PZhU-të e të dyja komunave janë finalizuar dhe aprovuar nga MMPH. Për më tepër, që të dyja komunat i kanë identifikuar vendbanimet joformale në planet hapësinore të tyre. Komuna e Gjakovës/Đakovica ka aprovuar PRrU-të lidhur me vendbanimet joformale, ndërsa komuna e Pejës/Peç është duke i përgatitur dhe planifikon t'i finalizojë në 2011. Shumica e komunave në rajonin e Pejës/Peç kanë nënkontraktuar kompani ndërkombëtare dhe vendore për përgatitjen e planeve hapësinore.⁵⁴ Disa komuna gjithashtu janë përkrahur nga organizata ndërkombëtare gjatë përgatitjes së planeve hapësinore të tyre.⁵⁵

Komuna e Pejës/Peç dhe e Gjakovës/Đakovica preferojnë opsionin e rregullimit në vend. Përjashtim përmben vendbanimi "Kolonja" në Gjakovë/Đakovica ku, për shkak të mosarritjes së marrëveshjes për këmbim të tokës⁵⁶ ndërmjet Agjencisë Kosovare të Privatizimit⁵⁷ dhe komunës, është vendosur që të bëhet zhvendosja e banorëve në një lokacion të afërt. Për më tepër, vendbanimi gjendet afër deponisë komunale të mbeturinave që shkakton ndotjen e konsiderueshme të mjedisit dhe ndikon negativisht në shëndetin e banorëve. Sipas zyrtarëve, komuna ka ndarë një parcelë toke pranë vendbanimit të tanishëm dhe familjet që do të zhvendosen aty do të marrin të drejtën e shfrytëzimit të saj.⁵⁸ Ndërsa në vendbanimet e tjera përmirësimet e bëra janë kryesisht të lidhura me modernizimin e infrastrukturës, gjegjësisht ndërtimin e rrugëve, përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kyçjes në rrjetin e kanalizimit.

Ndonëse vendbanimi joformal i "Rudeshit/Rudeš" në komunën e Istogut/Istok është rregulluar përmes rivendosje para kohës së raportimit, ia vlen të përmendet meqë ofron njohuri të hollësishme për skenarë të ndryshme që pasqyrojnë një reagim pozitiv nga komuna. Sipas zyrtarëve komunalë, në "Rudesh/Rudeš" banonin romë dhe egjiptianë të Kosovës që ishin zhvendosur si rezultat i konfliktit të vitit 1998–1999. Shumica e parcelave të tokës ishin në pronësi shoqërore⁵⁹ dhe, për t'u komplikuar edhe më tej, hapësira gjithashtu ishte brenda një zone të veçantë të mbrojtur të Manastirit Ortodoks serb të Gorioçit, gjë që i ndalonte aktivitetet ndërtuese⁶⁰. Rrjedhimisht, ndonëse komuna ishte e gatshme të përkrahte kthimin në këtë vendbanim joformal, nuk kishte mundësi ta bënte një gjë të tillë për shkak se nuk mund të siguronte siguri të zotërimit në këtë zonë të veçantë. Megjithatë, në dhjetor 2008, kuvendi komunal e miratoi dhënien në shfrytëzim të tokës në pronësi komunale në fshatin Serbobran/Srbobran për të kthyerit potencialë nga vendbanimi i "Rudeshit/Rudeš", ndërsa Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) siguroi fonde për ndërtimin e shtëpive. Përfituesit fituan pronësinë mbi shtëpitë, të cilat janë të regjistruara në emrat e tyre në kadastrë, ndërkohë që atyre iu dha e drejta për shfrytëzim të tokës ku janë ndërtuar

⁵⁴ Komuna e Pejës/Peç e ka kontraktuar kompaninë ndërkombëtare "DHV Group", komunat e Istogut/Istok dhe Klinës/Klina kompaninë "Urban Plus", komuna e Junikut kompaninë "MetroPolis" dhe e Deçanit/Deçane kompaninë "Terrasystems Austrian Geotechnik".

⁵⁵ UN Habitati i ka përkrahur komunat e Pejës/Peç dhe Gjakovës/Đakovica, ndërsa Trashëgimia Kulturore pa Kufij e ka përkrahur komunën e Junikut.

⁵⁶ Termi këmbim tokash i referohet procedurës me të cilën tokat nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit mund t'ju jepen në shfrytëzim komunave për qëllime të përfitimit publik. Neni 9 i Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

⁵⁷ Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar në 21 maj 2008 në bazë të Ligjit nr. 03/L-067 si organ i pavarur publik që është përgjegjës për administrimin, privatizimin dhe shitjen e ndërmarrjeve shoqërore. Që nga koha e raportimit, ky ligj është zëvendësuar me Ligjin Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, 21 shtator 2011.

⁵⁸ Nga sa na është thënë, projekti është në vazhdim e sipër dhe tenderi i parë për ndërtimin e 29 shtëpive është publikuar në shtator 2010, ndërsa ndërtimi i 91 shtëpive të tjera do të varet nga donacionet e mundshme dhe me gjasë do të zbatohet deri në 2011.

⁵⁹ Sipas zyrtarëve komunalë, ato ishin të regjistruara në emër të ndërmarrjes shoqërore "Ekonomia Pyjore".

⁶⁰ Ligji nr. 03/L-039 për Zonat e veçanta të mbrojtura, 20 shkurt 2008.

shtëpitë në periudhë kohore prej 10 vjetësh. Komuna është duke kërkuar mënyra për zgjatjen e periudhës kohore e së drejtës për shfrytëzim.

Rajoni i Prishtinës/Priština

Gjatë kohës së kryerjes së intervistave me komunat e rajonit të Prishtinës/Priština, Obiliqi/Obilić dhe Glllogoci/Glogovac i kishin aprovuar PZhK-në dhe PZhU-në, ndërsa komunat e tjera ishin në fazën e përgatitjes së këtyre planeve. Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje e ka aprovuar PZhU-në e saj që në 2005. Komunat e Gračanica/Gračanicës, Prishtinës/Priština dhe Fushë Kosovës/Kosovo Polje i kanë aprovuar PRRU-të, megjithatë ai i Fushë Kosovës/Kosovo Polje daton nga viti 2005. Përveç Glllogocit/Glogovac dhe Gračanica/Gračanicës, të gjitha komunat janë përkrahur nga organizata të jashtme gjatë procesit të planifikimit hapësinor.⁶¹

Sipas zyrtarëve, të gjitha komunat e kanë përfshirë secilin vendbanim joformal të identifikuar në planet e tyre hapësinore. Për më tepër, të gjitha komunat kanë deklaruar t'i kenë përdorur udhëzimet e MMPH-së, por që këtë e kanë bërë me qëllim të identifikimit të vendbanimeve joformale. Komuna e Gračanica/Gračanicës ka filluar përgatitjen, ndërsa komuna e Glllogocit/Glogovac planifikon të fillojë përgatitjen e planeve të veçanta të rregullimit.

Të gjitha komunat kanë deklaruar që planifikojnë të bëjnë rregullimin në vend të vendbanimeve joformale. Në anën tjetër, ato gjithashtu kanë deklaruar që mungesa e fondeve për ndërtimet e nevojshme dhe për përmirësimin e infrastrukturës do të jetë një pengesë të madhe për realizimin e këtyre planeve.

Rajoni i Gjilanit/Gnjilane

Gjatë kohës së kryerjes së intervistave me komunat e rajonit të Gjilanit/Gnjilane, vetëm Gjilani/Gnjilane dhe Ferizaj/Uroševac kishin aprovuar PZhK-të dhe PZhU-të e tyre. Komunat e tjera të këtij rajoni janë në proces të përgatitjes të PZhK-ve dhe PZhU-ve të tyre, me përjashtim të komunës së Klokot/Klllokotit ku procesi ende nuk ka filluar. Të gjitha komunat po i përgatitin PRRU-të, me përjashtim të komunave të Hanit të Elezit/Đeneral Janković dhe Štrpce/Shtërpcës të cilat ende nuk kanë filluar përgatitjen. Sipas zyrtarëve komunalë, përveç komunave të Ferizajt/Uroševac, Kaçanikut/Kaçanik⁶² dhe Klokot/Klllokotit, të gjitha komunat e tjera janë përkrahur nga organizatat e jashtme⁶³.

Shumica e komunave që i kanë identifikuar vendbanimet joformale i kanë përfshirë që të gjitha në planet e tyre hapësinore. Mirëpo, komuna e Ferizajt/Uroševac nuk i ka përfshirë dy

⁶¹ Komuna e Podujevës/Podujevo është përkrahur nga EULOG (projekt i BE-së i menaxhuar nga ZNKE për ndihmë komunave për përgatitjen e PZhK-ve të tyre dhe zhvillimin e kompetencave të nevojshme për zbatimin e tyre). Komuna e Prishtinës/Priština është përkrahur nga kompani gjermane, angleze dhe sllovene (megjithëse zyrtari i komunës nuk e saktësoi se për cilat kompani bëhej fjalë). Komunat e Obiliqit/Obilić dhe Fushë Kosovës/Kosovo Polje gjithashtu janë përkrahur, mirëpo zyrtarët e këtyre komunave nuk mundën të specifikojnë se nga kush). UN Habitat dhe PZhKB kanë shprehur interesim për të përkrahur komunën e Gračanica/Gračanicës, por në kohën e mbajtjes së intervistës komuna ende nuk u ishte përgjigjur propozimeve të tyre.

⁶² Sipas komunës, ata kanë kërkuar përkrahje nga UN Habitat mirëpo kërkesa e tyre nuk është plotësuar.

⁶³ Sipas zyrtarëve komunalë, UN Habitat ka ndihmuar Gjilanin/Gnjilane dhe Hanin e Elezit/Đeneral Janković; PZhKB ka ndihmuar Ranilug/Ranillugun; Projekti zviceran-kosovar për përkrahje qeverisjes lokale dhe decentralizimit (LOGOS) ka ndihmuar Štrpce/Shtërpcën, Kamenicën/Kamenica dhe Novo Brdo/Novobërdën; dhe, OJQ “Elita”, OJQ “Alternativa” dhe OSBE kanë ndihmuar Vitinë/Vitina.

nga gjashtë vendbanimet e saj⁶⁴, ndërsa ajo e Kamenicës/Kamenica nuk e ka përfshirë asnjë. Sipas komunës së Kamenicës/Kamenica, vendbanimet joformale nuk janë përfshirë për arsye se planet hapësinore janë ende në përgatitje e sipër. Të gjitha komunat që i kanë identifikuar vendbanimet joformale kanë deklaruar të kenë shfrytëzuar udhëzimet e MMPH-së gjatë fazës së përgatitjes të planit hapësinor. Katër komuna që nuk e kanë identifikuar asnjë vendbanim joformal⁶⁵ kanë deklaruar të mos kenë qenë në dijeni apo edhe të mos i kenë pranuar udhëzimet e MMPH-së fare.

Prej komunave që i kanë identifikuar vendbanimet joformale, vetëm komunat e Gjilanit/Gnjilane dhe Vitisë/Vitina kanë përgatitur plane të veçanta të rregullimit dhe që të dyja po përdorin katër kritere për të caktuar prioritetin sipas të cilit do të rregullohen vendbanimet: 1) pasiguria e zotërimit të pronës; 2) qasja joadekuate në shërbime dhe në infrastrukturë themelore, dhe 3) mosnjohja nga autoritetet komunale si pjesë përbërëse dhe e barabartë e njësisë komunale dhe 4) rreziku për diskriminim. Këto kritere gjithashtu pasqyrojnë përkufizimin e këtyre komunave për vendbanimet joformale.

Të gjitha komunat e rajonit të Gjilanit/Gnjilane kanë zgjedhur rregullimin në vend si opsion të preferuar. Në të vërtetë, shumica syresh kanë deklaruar se ky është opsioni i vetëm që e kanë konsideruar. Të vetmin përjashtim nga kjo e përbën komuna e Kamenicës/Kamenica, e cila nuk ka vendosur për rregullimin në vend ose rregullimin përmes rivendosjes sepse, sipas komunës, planet hapësinore janë në përgatitje e sipër dhe vendbanimet joformale ende nuk janë përfshirë në këto plane. Secila komunë ka deklaruar që prioritet i tyre është përmirësimi i qasjes në shërbime publike dhe infrastrukturë, ndërsa komuna e Kaçanikut/Kaçanik gjithashtu i është referuar në mënyrë të veçantë përmirësimit të qasjes në shërbime shëndetësore dhe arsim. Komunat e Ferizajt/Uroševac dhe e Vitisë/Vitina gjithashtu kanë theksuar që si prioritet kanë zgjidhjen e problemeve lidhur me zotërimin e tokës. Zyrtarët komunalë të Hanit të Elezit/Đeneral Janković kanë deklaruar që nuk kanë ndonjë ide të qartë rreth mënyrës se si mund të përmirësohet gjendja në vendbanimin joformal që kanë identifikuar, sidomos duke qenë se rrëshqitjet e dheut përbëjnë një rrezik serioz në atë lokacion.

Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica

Gjatë kohës së kryerjes së intervistave me komunat jugore, komunat e Mitrovicës/Mitrovica dhe Skenderajt/Srbica ishin në faza të ndryshme të përgatitjes të PZhK-ve, PZhU-ve dhe PRRU-ve të tyre. Komuna e Vushtrrisë/Vučitrn e ka finalizuar PZhK-në dhe PZhU-në e saj për periudhën 2009–2014. Që të gjitha janë përkrahur në ndonjë mënyrë nga organizatat e jashtme.⁶⁶ Secila nga këto komuna ka deklaruar të ketë përfshirë të gjitha vendbanimet joformale të identifikuar në planet e saj dhe shfrytëzuar udhëzimet e MMPH-së gjatë fazës së përgatitjes të planeve.

Komuna e Mitrovicës/Mitrovica tanimë i ka të përfunduara, ndërsa komunat e Skenderajt/Srbica dhe Vushtrrisë/Vučitrn janë në proces të përgatitjes së planeve të veçanta të rregullimit që synojnë në radhë të parë zgjidhjen e rasteve më urgjente. Mitrovica/Mitrovica

⁶⁴ Lagjja “Koçi Xoxe” dhe fshati Dubravë/Dubrava nuk janë përfshirë në planet hapësinore të Ferizajt/Uroševac. Kjo është në veçanti befasuese në rastin e fshatit Dubravë/Dubrava ku kushtet në përgjithësi janë vlerësuar si shumë të këqija.

⁶⁵ Štrpce/Shtërpca, Novo Brdo/Novobërda, Klokot/Kllokoti dhe Ranilug/Ranillugu.

⁶⁶ Sipas zyrtarëve komunalë, UN Habitatit ka ndihmuar Mitrovicën/Mitrovica dhe Skenderajn/Srbica përmes trajnimeve për zhvillim strategjik urban. Komuna e Vushtrrisë/Vučitrn ka kontraktuar byronë për urbanizëm “INTEG” nga Prishtina/Priština për projektimin e planeve të saj.

dhe Skenderaj/Srbica kanë zgjedhur opsionin e rregullimit në vend dhe të dyja planifikojnë të: 1) bëjnë një hartë të zonave të prekura; 2) të bëjnë ndarjen në zona për të mundësuar ndërtimin e objekteve të banimit dhe; 3) të rregullojnë ose të legalizojnë vendbanimet. Megjithatë, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn gjithashtu do të preferonte t'i rivendoste banorët në ndërtesa për banim social, sepse ata konsiderojnë se banesat e tyre aktuale (një ish shtëpi shëndeti, ish kazermë dhe një ish objekt i kooperativës) nuk janë të ndërtuara për qëllime banesore, banorët kanë qasje shumë të dobët në infrastrukturë themelore dhe nuk kanë të drejtë të shfrytëzimit të tokës.

Të gjitha komunat veriore të rajonit të Mitrovicës/Mitrovica punojnë me plane hapësinore që datojnë që nga vitet e 90-ta, ndonëse komunat e Zvečan/Zveçanit dhe Zubin Potokut kanë zhvilluar disa plane rregulluese të reja. Asnjë nga komunat veriore nuk i shfrytëzon udhëzimet e MMPH-së.⁶⁷

Siç u përmend më herët, komunat e Mitrovica/Mitrovicës veriore dhe Leposavić/Leposaviqit janë dy entitetet veriore të vetme që kanë identifikuar vendbanime joformale, të cilat në të njëjtën kohë shfrytëzohen edhe si qendra kolektive të përkohshme për personat e zhvendosur. Ndonëse qendrat kolektive në Mitrovica/Mitrovicën veriore kanë qenë në fokus të programeve për lehtësimin e risistemimit dhe reintegrimin⁶⁸, ende nuk është paraparë ndonjë zgjidhje për personat që janë të vendosur në kampin e Leposavić/Leposaviqit.

Përfundim

Gjatë kohës së kryerjes së intervistës, vetëm 12 komuna i kishin aprovuar PZhK-të⁶⁹. Shumica e komunave të tjera ishin në proces të përgatitjes të planeve, ndërsa pesë komuna⁷⁰ ende nuk kanë filluar t'i përgatitin. Dy nga këto PZhK kanë filluar të zbatohen pa marrjen e pëlqimit paraprak nga MMPH.⁷¹ PZhU-të janë aprovuar nga kuvendet komunale në 17 komuna.⁷² Përveç komunave veriore në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, pesë komuna⁷³ kanë deklaruar që nuk kanë në dijeni të udhëzimeve të MMPH-së dhe, si rezultat, nuk i kanë përdorur gjatë procesit të përgatitjes të planeve hapësinore. Kjo mund të shpjegojë deri diku

⁶⁷ Komunat e Leposavić/Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zvečan/Zveçanit zbatojnë vetëm legjislacionin e Republikës së Serbisë dhe disa rregullore të UNMIK-ut, ndërsa administrata në Mitrovica/Mitrovicën veriore zbaton vetëm rregulloret e UNMIK-ut dhe ligjet e Kosovës të dekretuara nga PSSP.

⁶⁸ Shih fusnotën 46, *supra*.

⁶⁹ Komunat e Glogocit/Glogovac, Shtimes/Štimlje, Obiliqit/Obilić, Pejës/Peć, Gjakovës/Đakovica, Deçanit/Dečane, Istogut/Istok, Gjilanit/Gnjilane, Ferizajt/Uroševac, Vushtrrisë/Vučitrn, Lipjanit/Lipljane, dhe Suharekës/Suva Reka. Qw nga koha e intervistave, gjashtw komuna tjera i kanë miratuar PZhK-të: Mitrovica/Mitrovicë, Juniku, Podujeva/Podujevo, Vitia/Vitina, Hani i Elezit/Đeneral Janković, dhe Kaçaniku/Kaçanik.

⁷⁰ Prishtina/Priština, Klokot/Kllokoti, Leposavić/Leposaviqi, Zubin Potoku dhe Zvečan/Zveçani. Që nga koha e intervistimit, Klokoti/Kllokoti ka filluar procesin hartimit të PZhK-së.

⁷¹ Komunat e Suharekës/Suva Reka dhe Lipjanit/Lipljane. Sipas nenit 13.9 të Ligjit për planifikim hapësinor, para aprovimit përfundimtar nga Kuvendi i Komunës, PZhK-të duhet t'i dorëzohen MMPH-së me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë me planin hapësinor të Kosovës.

⁷² Komunat e Glogocit/Glogovac, Shtimes/Štimlje, Obiliqit/Obilić, Fushë Kosovës/Kosovo Polje, Lipjanit/Lipljane, Gjilanit/Gnjilane, Ferizajt/Uroševac, Kaçanikut/Kaçanik, Pejës/Peć, Gjakovës/Đakovica, Deçanit/Dečane, Istogut/Istok, Suharekës/Suva Reka, Mitrovica/Mitrovicës, Vushtrrisë/Vučitrn, Prizrenit dhe Malishevës/Mališevo. Që nga koha e intervistimit, tri komuna tjera i kanë miratuar PZhK-të e tyre: Vitia/Vitina, Hani i Elezit/Đeneral Janković, dhe Skënderaj/Srbica

⁷³ Prizreni, Štrpce/Shtërpca, Novo Brdo/Novobërda, Klokot/Kllokoti dhe Ranilug/Ranillugu. Për më tepër, komunat veriore në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, (Leposavić/Leposaviqi, Zvečan/Zveçani dhe Zubin Potoku) nuk i përdorin udhëzimet e MMPH-së pasi që veprojnë sipas legjislacionit të Serbisë dhe rregulloreve të UNMIK-ut.

përse katër nga këto komuna⁷⁴ nuk kanë identifikuar asnjë vendbanim joformal në territorin që është nën përgjegjësinë e tyre.

Shumica e komunave që kanë identifikuar vendbanimet joformale kanë zgjedhur opsionin e rregullimit në vend, i cili është në përputhje me Deklaratën e Vjenës dhe udhëzimet e MMPH-së. Domethënë, ato preferojnë të gjejnë mënyra për të ofruar sigurinë e zotërimit të pronës dhe për ta përmirësuar qasjen në infrastrukturë në atë lokacion ku aktualisht banojnë banorët. Megjithatë, ka disa përjashtime të cilat vlejnë të përmenden. Në rastin e vendbanimit “Kolonja” në komunën e Gjakovës/Đakovica, komunës iu desh të aprovonte një strategji të rivendosjes për shkak të vështirësive në ofrimin e zotërimit të pronës meqë shtëpitë gjendeshin në një pronë shoqërore. Për më tepër, vendbanimi gjithashtu gjendet në zonën me rrezik mjedisor pranë deponisë së mbeturinave. Rrethanat e veçanta në rastin e “Kolonja” nënkuptuan që komuna nuk kishte zgjidhje tjetër përveç që t’i zhvendoste banorëve në mënyrë që të mund t’ju ofronte siguri të zotërimit të pronës, qasje më të mirë në infrastrukturë dhe një mjedis më të shëndetshëm për jetesë. Duke pasur parasysh qasjen këshillimore që komuna tregoi kundrejt komunitetit, rasti i “Kolonisë” mund të konsiderohet si një metodë pozitive e rregullimit për rastet kur zhvendosja është opsioni i vetëm⁷⁵.

Në mënyrë të ngjashme, siguria e zotërimit për vendbanimin joformal të “Rudeshit/Rudeš” në komunën e Istogut/Istok nuk mund të realizohej lehtësisht meqë shumica e parcelave të tokë ish në pronësi shoqërore dhe hapësira ishte gjithashtu brenda një zone të veçantë të mbrojtur të Manastirit Ortodoks serb të Gorioçit. Duke qenë kështu, komuna nuk kishte opsion tjetër përveç atij të rregullimit përmes rivendosjes.

Komuna e Prizrenit ka deklaruar që nëse në të ardhmen vendosë ta ndërtojë zonën e vendbanimit joformal, ajo do të preferonte t’i zhvendoste banorët e “Farmakos” dhe “Ramiz Sadiku” dhe t’ua lironte atë zonë kompanive private të ndërtimit. Komuna ka deklaruar që qëllimi i tyre është që tokën t’ua japin në dispozicion kompanive private për të ndërtuar objekte banimi dhe që banorëve që aktualisht kanë uzurpuar pronat komunale t’u ofrojnë strehim në objektet e reja. Vushtrria/Vučitrn gjithashtu ka zgjedhur zhvendosjen përmes ndërtimit të objekteve të banimit social në një lokacion alternativ. Ata konsiderojnë që me këtë do të përbusheshin më mirë kërkesat e banorëve të vendbanimeve joformale sepse banesat e tyre aktuale nuk janë të destinuara për banim, banorët kanë shumë pak qasje në infrastrukturën themelore dhe nuk kanë siguri të zotërimit. Në rastin e këtyre dy komunave, ofrimi i strehimit në banesa të reja të ndërtuara në zona përkatëse padyshim se do të përmirësonte kushtet e jetesës së banorëve. Mirëpo, komunat duhet të kenë parasysh rëndësinë e këshillimit të mirëfilltë me banorët dhe përfshirjen e tyre gjatë përgatitjes së projekteve të ndërtimit si një mënyrë për të siguruar që nevojat dhe shqetësimet e tyre të merren parasysh.

3.3 Pjesëmarrja në procesin e planifikimit hapësinor dhe të rregullimit

Korniza ligjore dhe e politikave në Kosovë e njeh të drejtën e anëtarëve të cilitdo komunitet për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes që kanë ndikim tek ata. Kjo e drejtë gjithashtu është e lidhur me kriterin e tretë përkufizues të vendbanimeve joformale, që i identifikon ato

⁷⁴ Štrpce/Shtërpca, Novo Brdo/Novobërda, Klokot/Kllokoti dhe Ranilug/Ranillugu.

⁷⁵ Diskutimi për aspektet e pjesëmarrjes së komuniteteve në vendimmarrje është shtjelluar më në hollësi në Pjesën 3.3 të këtij raporti.

si zona ku banorët nuk e kanë mundësinë e pjesëmarrjes adekuate apo nuk mund të marrin fare pjesë në qeverisje. Korniza ligjore dhe e politikave mundohet ta adresojë këtë mangësi. Njëri prej parimeve kryesore në të cilin bazohen udhëzimet e MMPH-së dhe të Deklaratës së Vjenës është që banorët duhet të jenë të përfshirë gjatë tërë procesit të planifikimit, duke filluar prej identifikimit të vendbanimeve joformale e deri te rregullimi i tyre. Të gjitha komunitetet dhe shoqëria civile duhet që gjithashtu të marrin pjesë në procesin e planifikimit hapësinor. Gjithashtu, Ligji për planifikimin hapësinor i obligon institucionet për “Promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes dhe përfshirjes në formulimin e strategjive zhvillimore dhe planeve fizike, që përfshin të gjitha palët e interesit dhe komunitetet pa asnjë diskriminim”⁷⁶ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor e njih edhe më tepër të drejtën e pjesëmarrjes si një aspekt të përkufizimit të tij për vendbanimet joformale: “pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje”⁷⁷ Edhe në udhëzimet e MMPH-së kjo çështje është munduar të adresohet duke theksuar nevojën për përfshirjen e banorëve në proceset e identifikimit dhe rregullimit.

Rajoni i Prizrenit

Komuna e Prizrenit nuk ka zhvilluar ndonjë mekanizëm të veçantë për përfshirjen e banorëve të vendbanimeve joformale të identifikuar në procesin e rregullimit. Sipas komunës, shqetësimet e tyre banorët ia adresojnë komunës në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pjesëmarrja e tyre sigurohet, në teori, përmes shqyrtimeve publike që mbahen gjatë procesit të përgatitjes së planeve hapësinore. Romët të cilët banojnë në lagjen “Jeta e Re” kanë përfaqësuesin e tyre në zyrën komunale për komunitete dhe kthim, i cili ka mundësi që përmes kësaj zyre të adresojë çështjet që i preokupojnë ata. Për më tepër, siç u përmend në pjesën e mëparshme, nëse komuna e Prizrenit vendosë të nisë aktivitete ndërtimi në vendbanimet joformale të identifikuar, ajo do të duhet të sigurojë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të banorëve gjatë procesit të planifikimit.

Rajoni i Pejës/Peć

Të gjitha vendbanimet joformale të identifikuar në rajonin e Pejës/Peć kanë përfaqësuesit e tyre të cilët janë përgjithësisht përgjegjës për të ndërvëpruar me autoritetet komunale dhe organizatat vendore e ndërkombëtare. Mirëpo, sipas përfaqësuesve të vendbanimeve joformale, komunikimi me komunën në lidhje me proceset e vendimmarrjes në të shumtën e rasteve është i kufizuar në takime publike. Ky mekanizëm është joadekuat për të promovuar pjesëmarrjen e banorëve, pasi që zakonisht kufizohet me vendosjen e një njoftimi në tabelën e njoftimeve në komunë dhe, për pasojë, informata nuk arrijnë deri të banorët. Banorët e intervistuar kanë sugjeruar që dërgimi i njoftimeve në zonat e vendbanimeve do të ishte shumë më frytdhënës. Mospërfshirja e tyre në procesin e vendimmarrjes është konfirmuar nga njohuritë e tyre të mangëta për procesin e planifikimit hapësinor dhe për dobitë që do të mund të rridhnin nga një angazhim më aktiv në këtë proces. Njëjtë qëndron situata madje edhe me PRrU-të të cilat janë përgatitur dhe që në veçanti kanë të bëjnë me zonat e vendbanimeve joformale.

Përfundimisht nga kjo mungesë e qartë e këshillimit me banorët përbën vendbanimi “Kolonja” në komunën e Gjakovës/Đakovica, ku përfaqësuesi i komunitetit angazhohet me zyrtarët komunalë dhe bën pjesë në këshillin drejtues për zhvendosjen e vendbanimit joformal. Shkalla pozitive e përfshirjes së banorëve të vendbanimit “Kolonja” dhe e komunës është kryesisht rezultat i pranisë së vazhdueshme të OJQ-së ndërkombëtare “Bethany Christian

⁷⁶ Shih nenin 3 të Ligjit për planifikimin hapësinor.

⁷⁷ Shih nenin 2 po aty.

Service,” e cila ofron shërbime të përkrahjes së komunitetit dhe në vazhdimësi ka avokuar në emër të banorëve. Karitasi zviceran është gjithashtu i përfshirë në procesin e rivendosjes në aspektin teknik dhe financiar. Angazhimi i tyre ka qenë i rëndësishëm sepse marrja e pëlqimit të banorëve në formën e një marrëveshjeje trepalëshe⁷⁸ para fillimit të çfarëdo projekti të zhvendosjes/rindërtimit ishte një parakusht i rëndësishëm për përfshirjen e Karitasit zviceran në projekt.

Rajoni i Prishtinës/Priština

Shumica e vendbanimeve në rajonin e Prishtinës/Priština kanë një përfaqësues që merret me shqetësimet e përgjithshme të banorëve; mirëpo, ata kanë raportuar se në të shumtën e rasteve nuk kanë qenë të përfshirë në proceset e identifikimit dhe rregullimit. Për më tepër, të intervistuarit nuk identifikuan asnjë organizatë vendore ose ndërkombëtare që merrej me vendbanimet joformale në veçanti.⁷⁹ Të vetmin përjashtim e përbën fshati Kuvajt në komunën e Podujevës/Podujevo, ku një përfaqësues i fshatit dhe një përfaqësues i OJQ-së “Kuwait”⁸⁰ komunikojnë rregullisht me komunën. Në rastet e komunave të Fushë Kosovës/Kosovo Polje, Podujevës/Podujevo dhe Obiliqit/Obilić, angazhimi me komunën bëhet përmes përfaqësimit të komunitetit në organet komunale, siç janë kuvendi komunal dhe komiteti për komunitete.

Sipas përfaqësuesve të komuniteteve, përveç shqyrtimeve publike të obligueshme të planeve hapësinore, asnjë komunë në këtë rajon ka krijuar ndonjë mekanizëm të veçantë për përfshirjen e banorëve të vendbanimeve joformale në proceset e vendimmarrjes. Në Glllogoc/Glogovac, Obiliq/Obilić, Gračanica/Gračanicë dhe lagjen “Kodra e Trimave/Vranjevac” në Prishtinë/Priština, banorët kanë deklaruar që asnjëherë nuk kanë qenë të këshilluar lidhur me proceset e planifikimit hapësinor. Banorët e vendbanimeve në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Podujevë/Podujevo dhe lagjen “Dodona” në Prishtinë/Priština kanë thënë të kenë marrë pjesë në takimet publike. Është me rëndësi të theksohet se komunitetet e komunave të Fushë Kosovës/Kosovo Polje dhe Podujevës/Podujevo kanë përfaqësues në komitetet komunale për komunitete, të cilët janë mekanizëm i drejtpërdrejtë përmes të të cilit anëtarët e një komuniteti mund të informohen lidhur me zhvillimet dhe mund t’ia adresojnë komunës shqetësimet e tyre.

Rajoni i Gjilanit/Gnjilane

Në komunat e Ferizajt/Uroševac dhe Kamenicës/Kamenica, vendbanimet e banuara me romë shkallë dhe egjiptian të Kosovës përfaqësohen nga anëtarët e komitetit për komunitete, apo zyrtarët nga radhët e komuniteteve të tyre në zyrën komunale për komunitete. Në komunat e Gjilanit/Gnjilane, Kaçanikut/Kaçanik, Hanit të Elezit/Đeneral Janković dhe Vitisë/Vitina vendbanimet i kanë emëruar përfaqësuesit e fshatrave apo komuniteteve të cilët janë në kontakt me zyrtarët komunal. Në komunat e Ferizajt/Uroševac dhe Gjilanit/Gnjilane këto vendbanime të banuara nga Shqiptaret e Kosovës nuk i kanë identifikuar përfaqësuesit e tyre. Në komunat e Gjilanit/Gnjilane, Ferizaj/Uroševac dhe Kamenicës/Kamenica banorët, i kanë

⁷⁸ Në mes të Karitasit zviceran, komunës dhe komunitetit.

⁷⁹ Në Obiliq/Obilić, Gračanica/Gračanicë dhe Fushë Kosovë/ Kosovo Polje ka disa OJQ dhe organizata ndërkombëtare që merren me çështje të kthimit dhe asistencë humanitare, por jo në veçanti me vendbanimet joformale

⁸⁰ “Kuwait” është një OJQ që merret me çështje sociale të dhe ndërlidhura me vendbanim.

pranuar informatat dhe këshillat lidhur me të drejtat e banimit nga disa organizata ndërkombëtare.⁸¹

Sipas përfaqësuesve të vendbanimeve joformale, në shumicën e komunave në rajon ekzistojnë mekanizma për përfshirjen e banorëve të vendbanimeve joformale në proceset vendimmarrëse jashtë seancave të kërkuara publike për planifikim hapësinor. Mirëpo, në shumicën e rasteve zyrtarët komunal i kanë bërë vizitat fillestare në vendet e tyre me qëllim të identifikimit apo mbledhjes së informatave lidhur me kushtet nëpër vendbanime. Në komunat e Ferizajt/Uroševac, Gjilanit/Gnjilane dhe Kaçanikut/Kaçanik, banorët kanë raportuar se janë në përgjithësi të kënaqur me pjesëmarrjen e tyre në debatet publike. Është e qartë që pasja e përfaqësuesve në organet komunale apo e përfaqësuesit të komuniteteve në kontakt të rregullt me zyrtarët komunal ndihmon në informim më të mirë të banorëve dhe angazhimin e tyre në procesin e vendim-marrjes.

Në komunën e Hanit të Elezit/Đeneral Janković gjithashtu ekziston një mekanizëm joformal pasi që katër zyrtar komunal jetojnë në vendbanimin e vetëm joformal atje. Rrjedhimisht, shkëmbimi i informatave apo avokimi në komunë në emër të banorëve mund të ndodhë joformalisht. Përmes këtij kanali, komuna i shpërndarë pyetësor banorëve të vendbanimit joformal në mënyrë që t'i sigurojë komunës informatat relevante lidhur me atë zonë. Në rastin e komunës së Vitisë/Vitina kompania e angazhuar për hartimin e planeve hapësinore i ka vizituar vendbanimet për të marr informatat të detajuara dhe banorët në këtë vend janë informuar lidhur me procesin e rregullimit dhe planifikimit hapësinor. Duhet të theksohet që OJQ-ja lokale “Elita” avokon në mënyrë aktive për përmirësimin e kushteve të jetesës në vendbanimet joformale në komunën e Vitisë/Vitina dhe ato gjithashtu kanë organizuar një numër të debateve publike lidhur me këtë çështje.

Mirëpo, në rastin e komunës së Kamenicës/Kamenica nuk është bërë asnjë konsultim e as nuk është krijuar asnjë mekanizëm për komunikim. Banorët kanë theksuar që nuk janë konsultuar gjatë procesit të identifikimit e as që ndjehen që mendimet dhe brengat e tyre janë marrë para sysh nga komuna. Mungesa e përpjekjeve nga komuna për të përfshirë banorët në procesin e planifikimit ka kontribuar në ndjenjën e të qenit të painformuar dhe të lënë jashtë procesit të planifikimit.

Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica

Sipas përfaqësuesve të komunitetit, të gjitha vendbanimet joformale të identifikuar në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica i kanë përfaqësuesit e tyre të cilët në përgjithësi janë përgjegjës për të ndërvepruar me autoritetet komunale dhe organizatat ndërkombëtare dhe lokale. Në shumicën e rasteve ata janë përfaqësues të komunitetit derisa në Skenderaj/Srbica banorët përfaqësohen përmes zyrtarëve të tyre të zgjedhur në kuvendin komunal. Në përgjithësi, banorët e kanë mundësinë që të ndërveprojnë me zyrtarët komunal përmes debateve publike dhe këshillave konsultativ.

Në komunën e Mitrovicës/Mitrovica bashkësia ndërkombëtare ka ndihmuar në financimin e punimeve të kryera në lagjet “Mahallën e Romëve/Roma Mahala” dhe në “Brdjani/Kroin e Vitakut”. Në kuadër të kësaj është bërë edhe mbyllja e kampit të personave të zhvendosur në “Çesmin Lug” ku shumica e banoreve janë kthyer në “Mahallën e Romëve/Roma Mahala”.

⁸¹ Komisioneri i Lartë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, Programi I Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, Fondacioni për Shoqëri të Hapur, dhe një OJQ lokale, Programi për të Drejta Civile/Kosovë.

Bashkësia ndërkombëtare dhe autoritetet lokale janë përfshirë në projektet për krijimin e komiteteve që merren kryesisht me çështjet si shëndeti, arsimi, gjenerimi i të hyrave dhe marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve.

Sipas zyrtarëve në komunën e Skenderajt/Srbica, gjashtë vendbanimet joformale të banuara me shqiptarë të Kosovës janë në pozitë më të favorshme pasi që ato përfaqësohen përmes anëtarëve të zgjedhur të kuvendit komunal. Rrjedhimisht, avokimi në emër të vendbanimeve ka qarë në disa përmirësime të kushteve të jetesës, siç janë punimet në rrugë dhe qasja në arsim. Kjo mbështetet nga fakti që banorët në këto vendbanime joformale kanë raportuar se janë të kënaqur me nivelin e konsultimit nga komuna. Derisa banorët e vendbanimeve në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn përfshirë edhe shqiptarët e Kosovës kanë raportuar se kanë një komunikim të mirë me zyrtarët komunal, ata nuk kishin përfituar që shumë nga përmirësimet konkrete për shkak të mungesës së fondeve për ndërtim të banimit social, e cila është strategjia e preferuar e komunës për rregullim.

Konkludim

Në kundërshtim me parimin e theksuar në udhëzimet e MMPH, Deklaratën e Vjenës dhe ligjin e ndryshuar dhe plotësuar për planifikim hapësinor, shumica e komunave nuk e kanë themeluar asnjë mekanizëm formal përmes së cilit ata do të siguronin pjesëmarrjen e banorëve të vendbanimeve joformale në proceset e planifikimit hapësinor. Është e qartë nga intervistat me banorët e vendbanimeve joformale, që kjo mund t'i lë ata të painformuar lidhur me proceset e identifikimit, planifikimit dhe rregullimit që prekin jetën e tyre drejtpërsëdrejti. Kjo gjithashtu mund t'i lë ata me ndjenjën që brengat e tyre nuk janë marrë para sysh nga komuna. Mirëpo, disa shembuj pozitiv të krijimit të mekanizmave pjesëmarrës përfshijnë vendbanimin "Kolonja" në komunën e Gjakovës/Đakovica dhe disa kampe të personave të zhvendosur në Mitrovicë/Mitrovica, ku janë krijuar komitete drejtuese për rivendosje. Ky komitet përfshinë përfaqësues të komunitetit dhe siguron komunikim të rregullt ndërmjet komunave dhe banorëve.

Është gjithashtu e rëndësishme që të njihet roli thelbësor i anëtarëve të organeve komunale⁸² si dhe punonjësve tjerë komunal që banojnë në vendbanimet joformale në përfaqësimin e nevojave të komuniteteve të tyre drejtpërsëdrejti në komunë. Në përgjithësi, në vendet ku anëtarët e këtyre organeve komunale banojnë nëpër vendbanime joformale apo kanë lidhje të ngushta me pjesëtarët e komuniteteve të tyre, banorët kanë raportuar se janë më mirë të informuar lidhur me zhvillimet e vazhdueshme dhe kanë tendencë më të madhe për të qenë të informuar dhe për të marrë pjesë në takimet publike. Si të tillë ata janë më të përfshirë dhe kanë mendime më pozitive për proceset vendimmarrëse rregullative. Mirëpo, zhvillimi i këtyre mekanizmave joformal të pjesëmarrjes nuk duhet ta zvogëlojë obligimin e komunave për zhvillimin e mekanizmave specifik për ta lehtësuar pjesëmarrjen e banorëve në projektet planifikuese dhe zhvillimore për vendbanimet joformale.

4. KONKLUDIM

Në kohën e intervistave, 19 komuna në të gjithë Kosovën i kanë identifikuar 95 vendbanime joformale. Disa banorë të vendbanimeve joformale i kanë ndërtuar shtëpitë e tyre në tokën e tyre private derisa të tjerët banojnë në tokë komunale apo shoqërore. Në rastin e kësaj të fundit, siguria e zotërimit mund të jetë veçanërisht e vështirë për t'u arritur, duke i lënë

⁸² Zyra komunale për komunitete dhe kthim, kuvendi komunal dhe komiteti për komunitete.

kështu banorët në pozitë veçanërisht të cenueshme me mundësi të dëbimit me dhunë. Mungesa e qasjes në infrastrukturë themelore si dhe mungesa e qasjes në shërbimet sociale është gjithashtu tipar i njohur në shumë nga vendbanimet e identifikuara joformale, gjë që i lë banorët të jetojnë në kushte të varfërisë së skajshme. Për më tepër, shumë vendbanime joformale përcillen nga mungesa e dukshme në pjesëmarrje në qeveritë lokale dhe vendimmarrje.

Ky raport ka treguar që vazhdon të ketë një huti ndërmjet zyrtarëve komunal në Kosovë në të kuptuarin e konceptit të vendbanimeve joformale. Derisa shumica e komunave kanë demonstruar njohuri të mjaftueshme të kriterëve sa i përket zotërimit të sigurt dhe qasjes joadekuate në infrastrukturë dhe shërbime sociale, shumica e tyre nuk iu janë referuar kriterit të tretë të pjesëmarrjes joadekuate apo mospjesëmarrjes në qeverinë lokale. Disa komuna e përdorin konceptin e vendbanimeve joformale në mënyrë shumë të kufizuar duke i kategorizuar vetëm sa i përket mungesës së sigurisë së zotërimit të pronës apo duke i asocuar ato me praninë e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Kjo ka potencial që të përjashtojë shumë zona që ndryshe do të konsideroheshin si vendbanime joformale. Rrjedhimisht, këto zona mund të mos përfitojnë ndihmën e nevojshme për rregullim. Në një rast të kundërt me këtë, një komunë tjetër përdor përkufizim shumë të gjerë, duke përfshirë kështu të gjitha fshatrat në komunë. Në këtë rast, komuna mund të përfshijë zona që kanë kushte më të mira se sa ato që zakonisht asociohen si vendbanime joformale. Si të tilla, mund të mos i japin prioritet atyre zonave ku banorët janë më së shumti të cenueshëm dhe kanë më së shumti nevojë për ndihmë.

Një numër i komunave gjithashtu i ka identifikuar qendrat e përkohshme kolektive si vendbanime joformale. Një identifikim i të tillë është pranim që banorët e tyre kanë të drejtë në përmirësim të kushteve të jetesës, gjithashtu duhet të theksohet që banorët kanë të drejta tjera të personave të zhvendosur të cilat kërkojnë zgjidhje të qëndrueshme. Këtu përfshihet e drejta e tyre për t'u kthyer në vendin e prejardhjes apo të gjinden zgjidhje alternative të banimit të përhershëm jashtë qendrave të përkohshme kolektive.

Komunat luajnë rol qendror në trajtimin e çështjes së vendbanimeve joformale. Ato janë përgjegjëset kryesore për hartimin e planeve hapësinore, të cilat ofrojnë mundësi për identifikimin e vendbanimeve joformale dhe adresimin e disa çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë e zotërimit të pronës. Ato gjithashtu ofrojnë mundësi për të hartuar strategji për përmirësim të qasjes në infrastrukturë dhe shërbime sociale, Në pajtim me kornizën e politikave, shumica e komunave zgjedhin rregullimin *in situ* (në vend). Mirëpo, në disa raste, ku nuk ka siguri të zotërimit të pronës nuk ka qenë i mundur të bëhet në vend, strategjia e rivendosjes është zgjedhur si mundësia më e preferuar. Në rastin e “Kolonisë” në komunën e Gjakovës/Đakovica, kjo strategji ka qenë e suksesshme dhe e pranuar mirë nga komuniteti falë komunikimit efektiv dhe konsultimit ndërmjet komunës dhe banorëve.

Mirëpo, për dallim nga kjo është brengë që në përgjithësi ekziston një mungesë e dallueshme e pjesëmarrjes së banorëve të vendbanimeve joformale në procesin vendimmarrës. Në shumicën e komunave, mekanizmi i vetëm për pjesëmarrjen e banorëve të vendbanimeve joformale në proceset e planifikimit dhe rregullimit është debati publik që kërkohet me ligj. Në shumicën e rasteve kur banorët kanë lidhje të ngushta me përfaqësuesit e organeve komunale, ata janë të kënaqur me nivelin e informative që i kanë lidhur me proceset e planifikimit dhe kanë tendencë që të ndjehen që brengat e tyre janë marrë para sysh nga komuna. Mirëpo, në rastet kur banorët nuk kanë lidhje të tilla, ata kanë më tepër tendencë që të jenë të painformuar lidhur me zhvillimet aktuale dhe ndjehet të lënë jashtë nga proceset

vendimmarrëse. Në rastet e tilla, ekziston një nevojë më e madhe që komunat të marrin iniciativë për të vendosur kontakte me këto komunitete dhe për krijimin e mekanizmave formal për përfshirje dhe pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes.

Meqenëse shumë komuna janë në fazën e hartimit të planit hapësinor⁸³, kjo paraqet një moment të favorshëm që institucionet përgjegjëse të marrin në konsideratë çështjen e vendbanimeve joformale më për së afërmi, me vështrim kah rregullimi i atyre ekzistuese dhe parandalimi i krijimit të vendbanimeve joformale në të ardhmen. Kjo në mënyrë të padiskutueshme e përmirëson realizimin e të drejtave për banim dhe pjesëmarrje adekuate.

5. REKOMANDIME

Për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH):

- Në mënyrë që t'i identifikojë dhe rregullojë vendbanimet joformale ekzistuese përmes procesit të planifikimit hapësinorë, MMPH do të duhej të ofronte përkrahje të planifikuar teknike dhe trajnime për komunat.
- MMPH do të duhej ta lehtësonte shkëmbimin e informatave dhe praktikave më të mira ndërmjet komunave lidhur me rregullimin e vendbanimeve joformale.

Për komunat:

- Komunat që përballen me vështirësi në identifikimin e vendbanimeve joformale, duhet të kërkojnë përkrahje nga burimet në dispozicion dhe t'i shfrytëzojnë ato duke përfshirë udhëzimet e MMPH-së dhe Deklaratën e Vjenës.
- Praktika e rregullimit *in situ* kur plotësohen kushtet lidhur me sigurinë e zotërimit dhe kushteve adekuate të jetesës duhet të vazhdohet si mënyra më efektive e rregullimit të vendbanimeve joformale.
- Komunat duhet të sigurojnë pjesëmarrje efektive të banorëve, shoqërisë civile dhe institucioneve komunale në proceset e rregullimit të vendbanimeve joformale dhe kjo pjesëmarrje duhet të formalizohet.
- Duhet të vendoset dhe të forcohet shkëmbimi i informacioneve dhe praktikave më të mira lidhur me rregullimin e vendbanimeve joformale ndërmjet komunave
- Planet për trajtimin e qendrave të përkohshme kolektive për personat e zhvendosur duhet të sigurojnë që e drejta për t'u kthyer në vendin e tyre të prejardhjes apo për gjetjen e banimit alternativ të përhershëm jashtë qendrave të përkohshme kolektive të banorëve të tyre të respektohen në mënyrë adekuate.

Për bashkësinë ndërkombëtare:

- Bashkësia ndërkombëtare do të duhej të vazhdojë përkrahjen financiare dhe teknike për iniciativat që e adresojnë çështjen e vendbanimeve joformale bazuar në praktikatat ekzistuese më të mira dhe do të duhej t'i forcojë më tej kapacitetet në nivel komunal.

⁸³ Në kohën e intervistimit, vetëm 12 nga 37 komuna kishin plane zhvillimore të përfundurara dhe miratuara, derisa 20 ishin në fazën e hartimit dhe pesë ende nuk e kishin filluar procesin. Që nga ajo kohë, gjashtë komuna tjera i kanë miratuar planet e tyre zhvillimore. Gjithashtu, në kohën e intervistave 17 komuna i kishin miratuar planet zhvillimore dhe që nga ajo kohë edhe tri të komunave tjera i kanë miratuar planet e tyre zhvillimore. Shih fusnotën 69 dhe 70 dhe 72.

Shtojca I: Vendbanimet joformale të identifikuara nga komunat

Komuna	Vendbanimet joformale të identifikuara nga zyrtarët komunal	
Prizren	1	Farmakos
	2	Ramiz Sadiku
	3	Jeta e Re
Pejë/Peć	1	7 Shtatori
	2	Kristali
	3	Zatra
	4	Asllan Çeshme
Gjakovë/Đakovica	1	Kolonia
	2	Brekoc
	3	Piskota
Prishtinë/Priština	1	Ramiz Sadiku
	2	Dodona (ish Moravska)
	3	Kodra e Trimave/Vranjevac
Podujevë/Podujevo	1	Lagja e Ashkalive
	2	Fshati Kuvajtit
Obiliq/Obilić	1	Lagja Subotiq
	2	Lagja Azotika
	3	Fshati Plemetina/Plemetin
	4	Kampi Plemetina/Plemetin
	5	Janina Voda
	6	Obiliqi i Ri
	7	Fshati Dardhishta
	8	Lagja në fshatin Babin Most/Babimoc
Fushë Kosovë/ Kosovo Polje	1	Fshati Bresje
	2	Fshati Henc/Ence
	3	Fshati Lismir/Dobri Dub
	4	Vendbanimi 02
	5	Vendbanimi 07
	6	Vendbanimi 028
	7	Vendbanimi 029
Gllgovc/Glogovac	1	Poklek i Ri
	2	Feronikeli
	3	Komorani/Komorane
Gračanica/Gračanicë	1	Lagja Rome, Padalište dhe Lagja Voćar në qytetin e Gračanica/Gračanicës
	2	Laplje Selo/Llapllasellë
	3	Preoce/Preoc
	4	Badovac/Badoc
	5	Sušica/Sushicë
	6	Lepina/Llepi
	7	Skulanevo/Skullan
	8	Radevo/Radevë
	9	Dobrotin/Dobratin
	10	Donja Gušterica/Gushtericë e Ulet

	11	Gornja Gušterica/Gushtericë e Epërme
	12	Livadë/Livadje
	13	Suvi Do/Suhodoll
	14	Batuse/Batushë
	15	Ugljare/Uglar
Gjilan/Gnjilane	1	Lagja e paemëruar afër hallës së sporteve
	2	i paemëruar në afërsi të rrugës në Malishevë/Malisevo
	3	Arbëria/Qenar qeshme
	4	Zabeli (Fabrika e Bujqësisë)
	5	Abdullah Presheva
	6	i paemëruar përgjatë rrugës Gllama
	7	Dheu i Bardhë/Belo Zemlje
	8	i paemëruar përgjatë rrugës unazore
	9	i paemëruar ndërmjet Pasjakut dhe Livocit të Epërm/Gornji Livoc
	10	i paemëruar përgjatë rrugës për në Prishtinë/Priština
	11	Ivo Lola Ribar
	12	Zabeli
Viti/Vitina	1	Vitia 1
	2	Vitia 2
	3	Vitia 3
	4	Radivojc/Radivojce
	5	Drobesh/Drobeš
	6	Binçë/Binač
Ferizaj/Uroševac	1	Koci Xoxe/Koce Xoxe
	2	Dubrava
	3	Sallahane
	4	Halit Ibishi
	5	Fabrika e tubave
	6	Rrr. I. Rugova
Kaçanik/Kaçanik	1	Kashan
	2	Strazhë
	3	Pjesë e rrugës Agim Bajrami
	4	Dushkaja 1 dhe 2
	5	Ramadan Agushi
Kamenicë/Kamenica	1	Mahalla e romëve (qyteti Kamenicë/Kamenica)
	2	Mahalla e romëve (fshati Berivojcë/Berivojce)
	3	Mahalla e romëve (fshati Hogoshtë/Ogošte)
	4	Vendbanimi në fshatin Bosce/Boscë
Hani i Elezit/ Đeneral Janković	1	Brava
Mitrovica/Mitrovicë e veriut	1	Česmin Lug*
	2	Osterode
Mitrovicë/Mitrovica	1	Mahalla e Romëve/Roma Mahala
	2	Dy Korriku/Sitničko Naselje
	3	Brdjani/Kroi i Vitakut
Skenderaj/Srbica	1	Klinë e Epërme/Gornja Klina
	2	Turiqec/Turićevac

	3	Runik/Rudnik
	4	Çirez/Ćirez
	5	Prekaz i Epërm/Gornje Prekaze
	6	Kopiliq i Epërm/Gornji Obilić
Vushtrri/Vučitrn	1	Ambulanta e Vjetër
	2	Baraka
	3	Kooperativa/Preduzeća
Leposavić/Leposaviq	1	Kampi për persona të zhvendosur

* Që nga koha e raportimit, kampi në “Çesmin Lug” për personat e zhvendosur është mbyllur dhe banorët kryesisht janë kthyer në “Mahallën e Romëve/Roma Mahala” apo janë rivendosur përkohësisht ne kampin “Osterode”.